

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5979
E shtunë, 18 janar 2020
çmimi 0.40 €

Komunat paguajnë mbi
12 milionë euro për
vendimet gjyqësore IFAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ IFAQE 4-5

NËSE LV-LDK DËSHTOJNË,

QEVERIA TEKNIKE ËSHTË ALTERNATIVË



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se qeveria teknike është alternativa më e mirë për vendin nëse dështojnë bisedimet në mes të LV-së dhe

LDK-së për krijimin e qeverisë së re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo qeveri do të duhej ta përgatiste vendin për zgjedhje të reja pas gjashtë muajsh. Nitaj ka vlerësuar se skena politike në

Kosovë duhet të rikonfigurohet për t'i shmangur bllokatat e krijimit të institucioneve që po përsëriten vazhdimisht. Sipas tij, krijimi i dy blloqeve të mëdha politike në vend është i domosdoshëm

OPINION

SI TË NDALEN DËMET DHE
(MOS)BËRJA E
QEVERISË? F. 5

Shkruan: Faton
ABDULLAHU



FUSHA MAGNETIKE E
PËRÇUESIT BRENDA
SOLENOIDIT F. 11

Shkruan: Naim
KRASNIQI, fizikan



AKTUALE

LUMEZI: ÇELËSI I SUKSESIT NË
LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT
QËNDRON NË KONFISKIMIN E
PASURISË SË PËRFITUAR F. 2

BREGU: KUR POLITIKA ËSHTË NË
GJENDJE KRITIKE, VLERËSOHET
I NEVOJSHËM DIALOGU
PARLAMENTAR F. 2

EKONOMI

ATK-JA PËR 20 VJET KA
MBLEDHUR 4 MILIARDË
E 707 MILIONË EURO TATIME F. 8

KULTURË

EMIGRIMET SHQIPTARE DHE
PERSPEKTIVA E EUROPEIZIMIT
TË ALBANOLOGJISË F. 20

Begzad
BALIU



'BARDHËSITË E ATDHEUT'-
ENCIKLOPEDIA GJITHKOMBËTARE
ME, 30 MIJË DËSHMI DHE
DOKUMENTE GJITHKOMBËTARE
TË ATDHEUT... F. 15



FORMIMI I QEVERISË, THAÇI PARALAJMËRON SE DO TË MARRË VEPRIME KUSHTETUESE

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar të premtën se do të ndërmarrë veprime kushtetuese në rast se nuk gjendet zgjidhje për

formim e qeverisë. Ai ka kërkuar që sa më shpejt të bëhet propozimi për mandatarin për kryeministër. Thaçi ka thënë se shpreson

në vullnetin e mirë të spektrit politik që të gjendet një zgjidhje në përputhshmëri me votën e qytetarëve IFAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqiptarët e Malit të Zi duan rezultate konkrete nga Rama

TIRANË, 17 JANAR - Shqiptarët e Malit të Zi kërkojnë nga Qeveria shqiptare të heqë dorë nga korrupsionet e fjalëve, por të vihet në lëvizje për t'i zbatuar premtimet e dhëna. Madje në përgatitje të zgjedhjeve të tetorit ata bëjnë thirrje edhe për më shumë bashkëpunim nga shteti amë. Premtimet e Qeverisë shqiptare kanë qenë të shumta, por në realitet është bërë shumë pak. Roli i shtetit shqiptar të bashkëkombësit tanë që jetojnë në Mal të Zi, nuk është ndjerë dhe madje ata janë të pakënaqur me Tiranën zyrtare.

Ministri për të Drejta dhe Pakica në Qeverinë e Malit të Zi, Mehmet Zenka thotë se ka ardhur koha t'u jepet fund vizitave të korrupsionit, e të kalohet te veprimet konkrete. "Sa herë që takohemi, ne kërkojmë diçka, ata premtojnë dhe realizimi është zero. Ka ardhur koha që shteti shqiptar të ulet me shtetin malazez dhe të përcaktojë kërkesat afatmesme. Na duhen zgjidhje afatmesme dhe afatgjata", thotë Zenka. "Politikat afatmesme dhe afatgjata janë ato që duhen parë me emergjencë. Në këtë pikë ministri Zenka përmend dy prej tyre - përfaqësimi i

shqiptarëve në bazë proporcionaliteti dhe decentralizimi në Mal të Zi", shpreh Mehmet Zenka. Një optikë tjetër ka në këtë lexim të marrëdhënies mes dy shteteve zyrtari shqiptar i partisë së Milo Gjukanoviçit, DPS, Nikoll Gegaj. Ai i cilëson marrëdhëniet si model për t'u marrë shembull. "Nuk mund të themi se është ideal, por dukshëm është përmirësuar krahasuar me vitet e kaluara", thotë Gegaj. Viti që kemi nisur është një vit zgjedhor në Mal të Zi, e ku shqiptarët nga një deputet, shpresojnë



që përfaqësimi i tyre në kuvendin e ri të jetë së paku me dy ose tre ligjvënës. Por për të kapur këtë objektiv së pari duhet që forcat

politike të gjejnë gjuhën e bashkëpunimit, pasi përçarja që i ka karakterizuar në gjithë këto vite. (Ora News)

Merkeli: Shqipëria ka përmbushur shumë kërkesa, të nisin negociatat

Kancelarja gjermane Angela Merkel tha të premten në Berlin se Shqipëria ka përmbushur shumë kërkesa që i kishim vendosur, sidomos procesin e vettingut dhe tani ka ardhur koha që të çelen negociatat

PRISHTINË, 17 JANAR - Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, ka shprehur mbështetjen e saj për çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut pas një takimi me homologun kroat, Andrej Plenkoviç. Në një konferencë shtypi me kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenkoviç, duke folur për samitin e Ballkanit Perëndimor në Zagreb, Angela Merkel, tha, ndër të tjera, se "është shumë e rëndësishme që të ketë përparime në çeljen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut". Kancelarja gjermane u shpreh pro çeljes së negociatave me të dy vendet njëherazi, si me Maqedoninë e Veriut ashtu edhe

me Shqipërinë. "Shqipëria ka përmbushur shumë kërkesa që i kishim vendosur, sidomos procesin e vettingut dhe tani ka ardhur koha që të çelen negociatat", tha kancelarja gjermane. Merkel kujtoi, po ashtu, edhe se Maqedonia e Veriut e ka plotësuar kushtin që bllokonte deri tani çeljen e negociatave, arritjen e marrëveshjes me Greqinë për çështjen e emrit. "Nëse duam të jemi të drejtë, atëherë ne duhet t'i trajtojmë të dy vendet së bashku, pavarësisht se ato pastaj do të ndjekin procedura të ndryshme, në bazë të vlerësimeve që do t'u bëhen", tha kancelarja gjermane. Merkel tha se pas mosarritjes së një marrëveshjeje vitin e kaluar,



tani do ta trajtojnë çështjen edhe në Samitin e Këshillit të BE-së në Bruksel, qysh në muajin mars. Vëzhgues në Berlin llogarisin se nuk do të ketë marrëveshje para Samitit të Ballkanit Perëndimor në Zagreb, pra në maj të këtij viti. Së fundmi, presidenti

francez Emmanuel Macron, frenuesi kryesor i zgjerimit të BE-së, kishte dhënë sinjale zhblllokimi të qëndrimit të tij pas një takimi në Paris me kryeministrin kroat, Andrej Plenkoviç. Plenkoviç e përmendi në Berlin takimin e tij me Macronin, por nuk dha detaje.

Kroacia dhe më pas Gjermania kanë në dorë kryesinë e radhës së BE-së. Plenkoviç ndodhet në Berlin për të marrë pjesë në panairin e produkteve ushqimore, "Java e gjelbër", në edicionin e sivjetshëm të të cilit, Kroacia është vend partner. (dw)

Bregu: Kur politika është në gjendje kritike, vlerësohet i nevojshëm dialogu parlamentar

TIRANË, 17 JANAR - "Në kohën kur politika është në gjendje kritike, është shumë i nevojshëm dialogu parlamentar midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së për të ardhmen e rajonit. Prandaj, unë do ta propozoj nisjen e një dialogu të institucionalizuar. Në këtë drejtim, Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC) është i gatshëm për të lehtësuar një dialog të tillë", ka thënë sekretarja e Përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu, në hapjen e Konferencës së Komisioneve Parlamentare për Integrimin Evropian të vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit të

Evropës Jug-Lindore (COSAP) që është mbajtur të premten në Tiranë. Ajo ka thënë se RCC-ja është e gatshme të kontribuojë në këtë dinamikë të re përmes mbështetjes së dialogut dhe bashkëpunimit parlamentar, i cili mbetet një fener i qëndrueshëm në luftën e vazhdueshme për demokraci. "Trajtimi i çështjeve politike, ekonomike, sociale, mjedisore, kulturore dhe të sigurisë në rajonin tonë nuk është përgjegjësi vetëm e qeverive. Mbështetja parlamentare për reformat e ndërmarra është thelbësore për të siguruar që nevojat

dhe zëri i qytetarëve të dëgjohen, që gjithashtu qëndron në thelb të Procesit të Berlinit. Viti 2020 është një moment jetik për përcaktimin e rolit që parlamentet duhet të luajnë në të. COSAP është forumi më i mirë për të nisur këtë proces dhe për t'i përcaktuar modalitetet dhe përmbajtjen e këtij dialogu", ka thënë ajo. Në vitin 2015, si presidente e kësaj Konferencë, gjatë Kryesisë së Shqipërisë në COSAP, Bregu i ka propozuar këtij forumi krijimin e një dimensionit parlamentar në Procesin e Berlinit. "Shpreh bindjen se përfshirja e parlamenteve kombëtare në këtë proces rrit dhe



forcon më tej rolin mbikëqyrës të parlamenteve dhe, gjithashtu, ka potencialin për të kontribuar në forcimin e stabilitetit politik dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor.

Jam e kënaqur që liderët njohën rëndësinë e këtij propozimi, duke përfshirë qytetarët dhe përfaqësuesit e tyre në Procesin e Berlinit, në Samitin e Poznanit vitin e kaluar", ka përfunduar Bregu.

Formimi i qeverisë, Thaçi paralajmëron se do të marrë veprime kushtetuese

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar të premten se do të ndërmarrë veprime kushtetuese në rast se nuk gjendet zgjidhje për formim e qeverisë. Ai ka kërkuar që sa më shpejt të bëhet propozimi për mandatarin për kryeministër. Thaçi ka thënë se shpreson në vullnetin e mirë të spektrit politik që të gjendet një zgjidhje në përputhshmëri me votën e qytetarëve

**EPOKA
ERE**

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 17 JANAR - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, shpreson se spektri politik do të gjejë një zgjidhje politike që përputhet me votën e qytetarëve për formimin e qeverisë. Ai ka shtuar se shpreson se kjo zgjidhje do të ofrohet sa më shpejt, përndryshe ka paralajmëruar se do t'i ndërmarrë të gjithë hapat kushtetues dhe ligjorë. "Unë shpresoj në vullnetin e mirë të spektrit politik që të gjejë zgjidhje politike në përputhshmëri me votën e qytetarëve më 6 tetor. Shpresoj që kjo zgjidhje të jetë sa më e shpejtë, në anën tjetër do t'i

ndërmarrë të gjitha hapat kushtetues dhe ligjorë", ka thënë Thaçi të premten.

Përpjekja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për arritjen e një marrëveshje për bashkëqeverisje duket se është zbehur të enjten, pasi lideri i LV-së, Albin Kurti, ka refuzuar kërkesën e LDK-së që kësaj partie t'i kthehet posti i kryetarit të Kuvendit.

Në letrën drejtuar Isa Mustafës, Kurti i ka bërë thirrje LDK-së të heqë dorë nga largimi i Glauk Konjufcës prej kreut të Kuvendit dhe t'i rikthehet tryezës së bisedimeve për marrëveshje.

Ndërkaq lideri i LDK-së, Isa

Mustafa, ka thënë se letrën e Kurtit nuk e konsideron si përgjigje zyrtare, por i bën thirrje të japë kontribut për formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit. Njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur pes-

imizëm se mund të ndodhë një marrëveshje për bashkëqeverisje në mes të LV-së dhe LDK-së.

Deri më tani liderët e të dy partive, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, janë takuar disa herë me synimin për ta përmbyllur

një marrëveshje për koalicion, mirëpo të gjitha takimet kanë rezultuar të pasuksesshme. Në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit të vitit të kaluar Lëvizja Vetëvendosje ka dalë partia e parë me 29 deputetë, kurse LDK-ja e dyta me 28 deputetë.

IAP dhe ASK nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 JANAR - Me synim zhvillimin dhe shfrytëzimin e të dhënave statistikore, për t'i vlerësuar dhe për t'i zbatuar politikën dhe programet që ndikojnë në respektimin, në mbrojtjen dhe në avancimin e të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) kanë nënshkruar të premten një memorandum dypalësh të mirëkuptimit.

Të dy autoritetet respektive (IAP dhe ASK) kanë marrë në konsideratë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të miratuar nëpërmjet një rezolute të veçantë në janar të vitit 2018 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, e bazuar në agjendën 2030 dhe



Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e shtatorit 2015. Po ashtu, IAP dhe ASK kanë pasur parasysh standardet dhe instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Nenin 22 të Kushtetutës së vendit dhe rëndësinë e të dhënave statistikore, përfshirë

treguesit specifikë, në matjen e realizimit të të drejtave të njeriut dhe të zbatimit të rekomandimeve të mekanizmave ndërkombëtare dhe vendor për të drejtat e njeriut.

Zbatimi i Agjendës 2030 kërkon përkushtim për bashkëpunim dhe mirëkuptim, me qëllim

identifikimin dhe prodhimin e treguesve përkatës, përfshirë treguesit kontekstualë relevantë, të cilët bazohen në udhëzimet mbi treguesit e të drejtave të njeriut dhe në Qasjen ndaj të Dhënave të Bazuar në të Drejtat e Njeriut (HRBAD), të përpiluar nga Zyra e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (OHCHR). Treguesit (indikatorët) janë mjete thelbësore për vlerësimin e progresit në të drejtat e njeriut dhe në zbatimin e Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030. Marrëveshja e mirëkuptimit ndërmjet IAP-së dhe ASK-së e shtron rrugën për grumbullimin e të dhënave statistikore dhe zërthimin e tyre si një mënyrë për t'i adresuar sfidat me të cilat ballafaqohen grupet e synuara dhe të lëna anash.

Gjithashtu, dy institucionet nënshkruese përgjatë bashkëpunimit do të analizojnë dhe shkëmbejnë të dhëna relevante për treguesit e identifikuar, përshtatshëmrisht të disagreguara mbi bazat e mbrojtura nga diskriminimi, sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës dhe sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Po ashtu, IAP dhe ASK do të ofrojnë këshilla dhe ndihmë në mënyrë të ndërsjellë, në fushën e mandatit dhe ekspertizës që kanë, si autoritete të veçanta.

Brenda një afati pesëmbëdhjetëditor të dyja institucionet relevante do ta themelojnë grupin punues të përbashkët, respektivisht pikat e kontaktit në funksion të operacionalizimit të këtij memorandumit të mirëkuptimit.

Sigurohet materiali për intervenime në sy

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka siguruar materialin e nevojshëm për intervenim në sy, përfshirë thjerrëzat dhe materialin tjetër që nevojitet gjatë operacionit. Pacientët deri tash e kanë blerë

vetë, duke harxhuar qindra euro në barnatore private, kurse ShSKUK-ja ka ndarë rreth 600 mijë euro për blerjen e materialit punues, për operacione të natyrave të ndryshme, që kryhen në Klinikën e Syve. Tash, me zgjidhjen e problemit për

furnizim, pacientët shërbimet do t'i marrin pa para. Materiali punues do të shërbejë kryesisht për operacionet rreth problemeve me perden e syrit, segmentit të pasmë të syrit, shtypjen e syve, kanalën e lotit, kapakëve të syrit dhe për problemet e vëngërisë.





Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

Nëse LV-LDK dështojnë, qeveria teknike është alternativë

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se qeveria teknike është alternativa më e mirë për vendin nëse dështojnë bisedimet në mes të LV-së dhe LDK-së për krijimin e qeverisë së re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo qeveri do të duhej ta përgatiste vendin për zgjedhje të reja pas gjashtë muajsh. Nitaj ka vlerësuar se skena politike në Kosovë duhet të rikonfigurohet për t'i shmangur bllokadat e krijimit të institucioneve që po përsëriten vazhdimisht. Sipas tij, krijimi i dy blloqeve të mëdha politike në vend është i domosdoshëm

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 JANAR - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka kritikuar mënyrën e negociimit të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK) për të arritur një marrëveshje bashkëpunimi për formimin e qeverisë. Ai ka bërë me dije se nëse këto dy parti nuk pajtohen për bashkëqeverisje, zgjidhja më e mirë për vendin do të ishte qeveria teknike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Nitaj ka deklaruar se kjo

qeveri do ta përgatiste vendin për zgjedhje të reja pas gjashtë muajsh. "Në rast se nuk do të ketë një marrëveshje për qeveri, unë si alternativë e shoh krijimin e një qeverie teknike, që do ta përgatiste vendin për zgjedhje të reja pas gjashtë muajsh. Ndoshta kjo është zgjidhja më e mirë për situatën e krijuar", ka thënë Nitaj. Ai ka vlerësuar se LV-ja dhe LDK-ja kanë humbur besimin te njëra-tjetra dhe se marrëveshja është bërë gati e pamundur. Sipas tij, edhe nëse arrihet një marrëveshje në mes tyre, ajo vështirë se do të mbahet. "Unë kam përshtypjen se gjërat janë

më serioze se kaq. Thash që palët e kanë humbur besimin në njëra-tjetrën, negociatat janë bërë të rënda. Partneriteti, mbi të gjitha, kërkon mirëbesim dhe respekt të ndërsjellë dhe këto nuk i keni vërejtur për këta 100 ditë. Unë do ta konsideroja më të ndershme një përgjigje të prerë sesa tërhiqje e mos këput", ka deklaruar Nitaj.

Nënkryetari i AAK-së ka treguar se përgjegjësia kryesore për dështim të krijimit të qeverisë së re bie mbi liderin e LV-së, Albin Kurti. "Nesër askush nuk do të thotë se Isa Mustafa dështoi ta krijojë qeverinë, por Albin Kurti! Dhe rezultati në këto zgjedhje



është i atillë që e përjashton mundësinë që i pari të mos jetë qind për qind në akord me partnerin, për gjithçka, duke përfshirë edhe kryetarin e Kuvendit. Është e pakuptueshme të thuhet, unë gjysmën e marrëveshjes e bëra vet e tash po negociojmë për pjesën tjetër", ka është shprehur ai.

Nitaj ka folur edhe për mundësinë e bashkëpunimit të AAK-së me LV-në, nëse dështojnë bisedimet me LDK-në. "Nuk kemi qëndrim fare. Nuk kemi qëndrim sepse nuk kemi ardhur në atë stad. Po u hap kjo si mundësi, sigurisht se do të diskutohet dhe do të merret një qëndrim, por me aq sa unë marr vesh është pak e besueshme që Aleanca i hyn një aventure të tillë politike!", ka thënë Nitaj.

"Epoka e re": Z. Nitaj, LV-ja dhe LDK-ja nuk po mund të pajtohen rreth një marrëveshje për bashkëqeverisje tash e 100 ditë. Si i kemi parë këto negociata?

Nitaj: Këto kanë mundur të

kenë qenë gjithçka tjetër, por jo negociata. Njerëzit e përgjegjshëm nuk negociojnë në këtë mënyrë, me takime të njëjta e pa rezultat, me deklarata "me spec" në publik dhe me letra të gjata, ku njëra palë më të rëndësishme e ka poshtërimin e palës tjetër sesa rezultatin e bisedimeve. Kam frikë se ata e kanë humbur besimin te njerëjtëri dhe tani marrëveshja ose bëhet e pamundshme ose edhe po u arrit, ajo vështirë se do të mbahet. Ne jemi munduar të mos përzihemi as me qëndrime politike për këtë proces, por ai aq shumë u degrada sa nuk mbeti njeri imun ndaj saj! Marrëveshja për qeveri është konsideruar sfidë e lehtë dhe shikoni se sa e komplikuar është bërë. Merreni me mend kur këta do të duhet të përballen me sfida shumë më të mëdha se çfarë do të ndodhë.

"Epoka e re": Së fundi i kemi parë edhe ofertat e fundit të LV-së dhe të LDK-së për njëra-tjetrën. Vërtet për shkak të disa posteve

nuk po mund të pajtohen këto parti, apo problemi qëndron diku tjetër?

Nitaj: Unë e kam përshtypjen se gjërat janë më serioze se kaq. Thash që palët e kanë humbur besimin në njëra-tjetrën, negociatat janë bërë të rënda. Partneriteti, mbi të gjitha, kërkon mirëbesim dhe respekt të ndërsjellë dhe këto nuk i keni vërejtur për këto 100 ditë. Unë do ta konsideroja më të ndershme një përgjigje të prerë sesa tërhiq e mos këput.

"Epoka e re": Kush mendoni se është më shumë përgjegjës për moskrijimin e qeverisë së re?

Nitaj: Përgjegjësinë më të madhe për dështim gjithmonë e ka i pari. Ai duhet të shoh se ku i ka defektet që s'po mund ta krijojë qeverinë. Të tjerët, në rastin konkret LDK-ja e ka komoditetin të zgjedhë nëse do ose jo ta pranojë ofertën. Nesër askush nuk do të thotë se Isa Mustafa dështoi ta krijojë qeverinë, por Albin Kurti. Dhe rezultati në këto zgjedhje është i atillë që e përjashton mundësinë që i pari të mos jetë qind për qind në pajtim me partnerin për gjithçka, duke përfshirë edhe kryetarin e Kuvendit. Është e pakuptueshme të thuhet, unë gjysmën e marrëveshjes e bëra vet e tash po negociojmë për pjesën tjetër.

"Epoka e re": Nga analistë të ndryshëm është paralajmëruar se nëse nuk do të kemi një koalicion LV-LDK, mund të kemi një përpjekje të LV-së për të bërë një koalicion me AAK-në dhe Nismën. Cili është qëndrimi i AAK-së për këtë çështje?

Nitaj: Nuk kemi qëndrim fare. Nuk kemi qëndrim sepse nuk kemi ardhur në atë stad. Po u hap kjo si mundësi, sigurisht se do të diskutohet dhe do të merret një qëndrim, por me aq sa unë marr vesh është pak e besueshme që Aleanca i hyn një aventure të tillë politike.

"Epoka e re": Nëse LV-ja nuk arrin ta formojë qeverinë e re, cila është alternativa: zgjedhje të reja apo ndonjë qeveri gjithëpërfshirëse?

Nitaj: Vlerësoj se skena politike në Kosovë duhet të rikonfigurohet. E shoh të domosdoshme krijimin e dy blloqeve të mëdha politike, sepse kështu siç jemi, gjithmonë do t'i kemi të njëjtat telashe. Le të marrim mësim nga Britania e Madhe ose ShBA-ja për shembull, ku vendet me miliona votues, përcaktohen për njërin nga dy-tre forcat politike. Kjo duhet të ndodhë edhe nëse do të këtë marrëveshje por, në rast se nuk do të ketë një marrëveshje për qeveri, unë si alternativë e shoh krijimin e një qeverie teknike, që do ta përgatiste vendin për zgjedhje të reja pas gjashtë muajsh. Ndoshta kjo është zgjidhja më e mirë për situatën e krijuar.



Shkruan: Faton ABDULLAHU

SI TË NDALEN DËMET DHE (MOS)BËRJA E QEVERISË?

Akuzat, ofendimet dhe fajësimet, ndërmjet LV-së dhe LDK-së, tashmë nuk janë komunikime ndërpartiake, por janë një fushatë e re politike parazgjedhore. Duke pasur parasysh arsyet që po i sjell më poshtë, është më mirë të ndalet e keqja tani, duke mos e bërë qeverinë sesa ajo të ndodhë dhe përçarja të determinojë dëmet të pariparueshme dhe për kohë të gjatë.

1) Mungesa e përkrahjes nga ShBA-ja. ShBA-ja nuk e ka përkrahur dhe vazhdojnë të mos e përkrahin koalicionin e mundshëm LV-LDK. Ky hezitim dhe kjo mungesë e përkrahjes për koalicionin e mundshëm LV-LDK nga ana e ShBA-së, në rend të parë po ndodh për fajin e LV-së apo thënë më saktë mungesës së korrektesisë dhe papjekurisë së saj politike dhe për kohë të gjatë në raport me ShBA-në. Arsye tjetër pse ShBA-në nuk e përkrah këtë koalicion është LDK-ja. Jo pse ajo do të jetë e padëgjueshme dhe kundër koncepteve euroatlantike, por pse LDK-ja konsiderohet se nuk e ka as guximin, as strategjinë e nevojshme që ta kundërshtojë e lërë më ta ndal LV-në në rast të devijimeve të saj.

2) Mungesa e guximit për t'u ballafaquar me Serbinë. Edhe LV-ja edhe LDK-ja nuk do të ishin kaq hezituese, apo thënë edhe më troç kaq

frikacake për t'u ballafaquar me Serbinë, sikur të ishin në këtë koalicion me ndokënd tjetër. Mosbesimi i ndërsjellë i bënë që të dyja këto subjekte shumë hezituese dhe të pasigurta. Asnjë koalicion nuk do të ishte më frikacak dhe më hezitues për fatin e Kosovës sesa LV-LDK.

3) Mungesa e besimit të ndërsjellë. Në LDK janë të shumtë ata që mendojnë se, LV-ja është parti kundër institucioneve dhe identitetit shtetëror të Kosovës, se në thelb ata nuk janë pro amerikan por janë të majtë ekstrem, se kauza e tyre për bashkim kombëtar është aventurë e rrezikshme. Në anën tjetër në LV janë të shumtë ata që mendojnë se në LDK shkelin të gjitha parimet për të ardhur apo për të mbet në pushtet, se nuk kanë luftuar në luftë dhe se janë frikacak e të pabesë në paqe, se për shumë gjëra janë të njëjtë me PDK-në, por vetëm të qenit frikacak nuk i lë të bëhen më të këqij se ata.

4) Votat e pamjaftueshme. Moslexim i drejtë, por i qëllimshëm dhe djallëzor i rezultateve të fundit zgjedhore, sidomos prezantimi i tyre si fitore e madhe, i ka bërë që të dyja LV-në dhe LDK-në të papërmbajtura në grykësinë e tyre për të marrë më shumë pushtet në dëm të palës tjetër.

Komunat paguajnë mbi 12 milionë euro për vendimet gjyqësore

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 JANAR - Lëvizja FOL, në kuadër të projektit "Transparencë dhe llogaridhënie komunale për taksapaguesit", të mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, është në proces të monitorimit të pagesave komunale, të cilat rrjedhin si rezultat i vendimeve gjyqësore.

Elbasan Racaj nga Lëvizja FOL ka thënë se kanë monitoruar shumën e pagesave nga vendimet gjyqësore gjatë viteve 2017, 2018 dhe për periudhën janar - tetor 2019 në të gjitha komunat e Kosovës. "Komunat gjatë periudhës janar-tetor 2019 kanë paguar në total shumën prej 12,458,861.00 eurosh, gjegjësisht mesataren prej 2.22 përqindësh të buxheteve të tyre", ka thënë Racaj. Sipas tij, në

këtë periudhë gjashtë komunat me më së shumti pagesa, krahasuar me buxhetet e tyre fillestare, kanë qenë: Leposaviqi 1,334,356.02 euro (28.74 përqind të buxhetit komunal); Ferizaj 3,726,38.85 euro (10.08 përqind); Mitrovica e Jugut 1,254,422.54 euro (6.33 përqind); Deçani 401,069.37 euro (4.48 përqind); Glllogoci 550,829.24 euro (3.63 përqind); dhe Klllokoti 40,421.92 euro (3.26 përqind).

Sa i përket vitit 2018 shuma e paguar nga komunat për vendimet gjyqësore kanë qenë rreth 16,360,705.42 euro apo 3.28 përqind të buxheteve të tyre.

Ndërkaq për vitin 2017 komunat kanë paguar shumën prej rreth 8,142,310.0 eurosh apo mesataren prej 1.81 përqindësh të buxheteve. Sipas Racajt, sfida kryesore, në mbledhjen e këtyre të dhënave ka qenë gjetja e të njëjtave në raportet



financiare të komunave. Një pjesë e komunave nuk publikojnë raporte financiare, kurse një pjesë tjetër e komunave raportet financiare i publikojnë në forma të

ndryshme dhe vështirë të lexueshme nga publiku.

Lëvizja FOL, në kuadër të mbledhjes së këtyre të dhënave, ka shfrytëzuar raportet financiare të

komunave, të dhënat e ofruara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe të dhënat e publikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Shërbimi Korrektues me qendër gjysmë të hapur edhe në Lipjan

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës, me qëllim të zbatimit të programeve për risocializimin e të dënuarve dhe përgatitjen e tyre të paralirimit, ka filluar zbatimin e Rregullores së Brendshme për Transferimin e të dënuarve në pavijonin gjysmë të hapur në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Me këtë rregullore, çdo person i dënuar i cili është duke e vuajtur dënimin në Institucionet Korrektuese dhe është i vendosur në tretmanin e avancuar mund të transferohet në pavijonin Gjysmë të Hapur, i cili është si njësi e veçantë në Qendrën Korrektuese në



Lipjan.

Vendimin për transferimin e personit të dënuar e merr drejtori i

përgjithshëm i Shërbimit Korrektues me propozim të drejtorit të Institucionit Korrektues ose në bazë të kërkesës së personit të dënuar apo të ndonjë anëtarit të ngushtë të familjes.

Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë Penale dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet e aplikueshme në Kosovë, synon t'i korrektojë dhe risocializojë të dënuarit, duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën, religjionin si dhe të sigurojë ambient të sigurt për stafin, të dënuarit dhe shoqërinë.

Policia e Kosovës nderon William Walkerin

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka pritur në një takim ish-shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin William Walker, të cilin e ka njoftuar nga afër mbi angazhimet dhe aktivitetet policore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në vend. Në shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi drejtori Qalaj i dhuroi një pllakat policore Walkerit. William Walker ka ardhur në Kosovë me rastin e 21-vjetorit të masakrës së Reçakut.




Maksut Vezgishi kurator dhe Jehona Shyti komisionare e Kosovës për Bienalen e Venedikut 2020

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në bazë të kompetencave, ka emëruar komisionarin dhe kuratorin për edicionin e 17 të Bienales së Venedikut për Ekspozitën Ndërkombëtare të Arkitekturës për vitin 2020. Jehona Shyti është emëruar komisionare e Pavijonit të Republikës së Kosovës për pjesëmarrje në Bienalen e Venedikut, që për këtë vit mbahet Ekspozita Ndërkombëtare e Arkitekturës, për të 17-n herë me radhë. Ndërsa arkitekti Maksut Vezgishi është emëruar kurator i Pavijonit të Kosovës në këtë ngjarje të madhe ndërkombëtare.

Tema e sivjetme e ekspozitës, të cilën e ka përcaktuar Bienalja e

Venedikut, është "How we can live together", kështu që edhe tema me të cilën do të përfaqësohet Republika e Kosovës në këtë ngjarje do të jetë brenda këtij koncepti. Në bazë të vendimit të ministrit, komisionarja ka për detyrë të punojë ngushtë me kuratorin dhe ta mbështesë ekzekutimin dhe menaxhimin e projektit me të cilin do të përfaqësohet Kosova në Bienale si dhe ta zhvillojë komunikimin e dyanshëm me zyrtarët e Venedikut dhe me opinionin e gjerë.

Ndërkaq kuratori ka për detyrë që përmes kreacionit të tij ta zbatojë dhe realizojë projektin e Kosovës në Bienale, të cilën do ta zbatojë arkitekti prizrenas Maksut Vezgishi.



Mbahet konferenca vjetore e prokurorëve të Kosovës

Lumezi: Çelësi i suksesit në luftën kundër korrupsionit qëndron në konfiskimin e pasurisë së përfituar

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka thënë të premten se çelësi i suksesit në luftën kundër korrupsionit qëndron në konfiskimin e pasurisë së përfituar nga vepra penale si dhe nga marrja e fuqisë ekonomike grupeve kriminale, nëpërmjet ngrirjes e më pastaj edhe konfiskimit të pasurisë



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 JANAR - "Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është element shumë i rëndësishëm drejt rrugës së integritit të shtetit tonë në familjen e madhe evropiane. Publiku është duke pritur nga prokurorët që nëpërmjet hetimeve të mirëfillta dhe të paanshme të kontribuojë në pastrimin e shtetit, politikës dhe institucioneve nga korrupsioni, nepotizmi, abuzimi dhe çdo formë tjetër e krimit që i cenon marrëdhëniet juridiko-shoqërore. Çelësi i suksesit në luftën kundër korrupsionit qëndron në konfiskimin e pasurisë së përfituar nga vepra penale si dhe nga marrja e fuqisë ekonomike grupeve kriminale, nëpërmjet ngrirjes e më pastaj edhe konfiskimit të pasurisë" ka thënë kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi, në konferencën vjetore të Prokurorëve të Kosovës.

Ai ka thënë se kanë treguar vendosmëri për t'u përballur me çdo formë të krimit. "Në këtë rrugë nuk do të na ndalë askush, sepse ky është interesi i shtetit dhe ne veprimi në emër të shtetit. Prandaj, duhet të jemi unikë për ta treguar forcën që e përbëjmë të gjithë së bashku si Prokurori e Shtetit. Shpresoj që forca e këtij mesazhi do të kuptohet drejt edhe nga kolegët e rinj në duart e të cilëve do të jetë e ardhmja e sistemit prokurorial", është shprehur ai.

Lumezi ka thënë se gjatë vitit të kaluar kanë zgjedhur kryeprokurorët e dy prokurorive më të rëndësishme në Republikën e Kosovës, atë të Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë Themelore të Prishtinës, të cilët, sipas tij, duhet të kenë një rol më të madh në drejtimin e këtyre prokurorive, por njëkohësisht edhe përgjegjësi për punën e tyre ndaj kryeprokurorit të shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe presidenti Hashim Thaçi, i cili ka përgëzuar prokurorët për punën dhe duke i inkurajuar për profesionalizëm dhe pavarësi nga ndikimet e jashtme. Thaçi ka folur për mosdënimin e kriminelëve serbë që kryen krime makabre ndaj popullatës civile në Kosovë.

Presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova ka kaluar nëpër sisteme të drejtësisë në faza të ndryshme tash e mbi 20 vjet, ndërsa ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me mungesën e vendosjes së drejtësisë për viktimat e luftës. Këtu presidenti Thaçi ka përmendur misionet për sundimin e ligjit që kanë qenë në Kosovë, duke

përfshirë UNMIK-un, EULEX-in dhe paralelisht me to edhe Tribunalin e Hagës për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi, të cilat ka theksuar se nuk kanë bërë mjaft për dënimin e kriminelëve të Serbisë për vrasjet masive me qëllim të spastrimit etnik dhe as për dhunimin e mbi 20 mijë grave shqiptare.

Ky neglizhim, sipas presidentit Thaçi, përbën amnistim të këtyre krimeve nga drejtësia ndërkombëtare. "Ne jemi dëshmitarë që ka rreth 13 mijë civilë shqiptarë të vrarë nga shteti i Serbisë, rreth 20 mijë gra të dhunuara dhe rreth 1 300 fëmijë të vrarë, si dhe rreth 400 masakra të evidentuara. Të gjithë e dinë dhe askush nuk mund ta mohojë që ka pasur lëshime në procesin e ndjekjes së fajtorëve, ashtu siç ka pasur edhe një selektim etnik, ku Kosova, edhe pse ka qenë viktimë, është ndjekur e hetuar më shumë sesa Serbia, që ka qenë agresorja që ka kryer gjenocid dhe spastrim etnik. Lirisht mund të them se Kosova është hetuar më shumë sesa krimet e Luftës së Dytë Botërore", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka thënë se këto lëshime e kanë rënduar arritjen e paqes, pajtimin dhe normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Thaçi i ka inkurajuar prokurorët që të qëndrojnë larg ndikimit politik, por edhe larg ndikimit diplomatik.

Prokurorja Laura Pula paraqet objektivat e Prokurorit të Shtetit

Në kuadër të konferencës vjetore të prokurorëve, prokurorja nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Laura Pula, ka paraqitur objektivat e Prokurorit të Shtetit për vitin 2020 si dhe ka prezantuar planin e punës. Prokurorja Pula ka potencuar se objektivat e Prokurorit të Shtetit janë: avancimi i punës profesionale të Prokurorit të Shtetit, fuqizimi i besimit të publikut se Prokurori i Shtetit është profesional, transparent, llogaridhënës, efikas, efektiv dhe i

pavarur, si dhe forcimi i luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Po ashtu, prokurorja Pla, theksoi se digitalizimi dhe modernizimi i punës, forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe integritetit të prokurorit të shtetit janë objektiva të cilat ka ky institucion. Ndërkaq, një ndër objektivat e Prokurorit të Shtetit është edhe sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve të fituara me vepër penale. Prokurorja Pula tha se mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe

krijimi i një ambienti të sigurt për të gjithë janë gurë themele të punës së Prokurorit të Shtetit, kurse vendosja para përgjegjësisë e të gjithë shkelësve të ligjit dhe ndjekja deri në dënimin meritor është synimi parësor, duke theksuar se Prokurori i Shtetit do të vazhdojë të jetë i pavarur, i drejtë dhe ta kërkojë vënien e drejtësisë në çdo rast, duke vepruar me etikë, profesionalizëm të lartë dhe duke u përpjekur për ta arritur përsosmërinë.

Përkujtohen vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Liderët shtetërorë dhe ata partiakë kanë përkujtuar të premten tre veprimtarët e shquar të lëvizjes kombëtare Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka, të cilët para 38 vjetëve u vranë nga segmente të shërbimit sekret jugosllav. "Ishte një goditje e rëndë për lëvizjen patriotike si jashtë ashtu edhe brenda Kosovës, pikërisht kur po

bashkërendoheshin grupet politike në një front të përbashkët. Edhe pas katër dekadave ende nuk është zbardhur ky krim i kryer në Gjermani", ka shkruar presidenti Hashim Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën. Ai ka thënë se këta tre veprimtarë kanë lënë

trashëgim të mijëra të tjerë, planet e lirisë. "17 janari i vitit 1982 nuk ishte datë e vdekjes për ta, por dita e përjetësisë së tyre", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka i kanë përkujtuar edhe lideri i LV-së, Albin Kurti, ai i LDK-së, Isa Mustafa, kryetari i PDK-së, Kadri Veseli dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj.



ATK-ja për 20 vjet ka mbledhur 4 miliardë e 707 milionë euro tatime

"Si rezultat i punës profesionale, me integritet dhe ndershmëri, efektivitet dhe transparencë, ATK-ja për këta 20 vjet ka mbledhur 4 miliardë e 707 milionë euro tatime dhe 1 miliard e 797 milionë euro kontribute. Përveç kësaj, ATK-ja ka zhvilluar një strukturë organizative funksionale, e cila në pjesën më të madhe të saj është në harmoni me praktikën më të mira ndërkombëtare", ka thënë të premten drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të këtij institucioni



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka shënuar të premten 20-vjetorin e themelimit. Në shënimin e 20-vjetorit të themelimit të ATK-së, drejtori Ilir Murtezaj ka thënë se ky institucion përgjatë gjithë këtij rrugëtimi është ndeshur me sfida të mëdha, në të njëjtën kohë ka arritur edhe sukses të jashtëzakonshëm, të cilat kanë reflektuar në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. "Si rezultat i punës profesionale, me integritet dhe ndershmëri, efektivitet dhe transparencë, ATK-ja për këta 20 vjet ka mbledhur 4 miliardë e 707 milionë euro kontribute. Përveç kësaj, ATK-ja ka zhvilluar një strukturë organizative funksionale, e cila në pjesën më të madhe të saj është në harmoni me praktikën më të mira ndërkombëtare", është shprehur Murtezaj. Zëvendësministri i Financave në detyrë, Mustaf Grainca, ka thënë se ATK-ja ka rritur integritet të lartë profesional dhe është dëshmuar si institucion kredibil. "ATK-ja është një ndër institu-

cionet me më shumë përgjegjësi kryesore për administrimin e tatimeve që me një detyrë fisnike dhe përgjegjësi të veçantë në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Gjatë këtyre viteve ATK-ja ka arritur nivelin e një institucioni kompetent me integritet të lartë profesional dhe është ngritur në nivel të ngjashëm me

administratat moderne ndërkombëtare", ka deklaruar Grainca. Ndërsa në emër të komunitetit të

bizneseve, drejtori i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se janë të shumta të arriturat e ATK-së për 20 vjet

edhe në aspektin legjislativ, por që kërkoi që të ketë edhe më tej bashkëpunim të ndërsjellë me bizneset në vend. "Kanë ende shumë punë për të bërë për përmirësimin e mëtejme edhe të raporteve të ndërsjella, natyrisht edhe të rritjes së besimit të bizneseve në Administratën Tatimore të Kosovës. Përpjekje edhe më të mëdha të ATK-së në luftimin e ekonomisë joformale, po ashtu edhe në ofrimin e mekanizmave të pavarur për zgjidhjen e kontesteve që bizneset mund të kenë në ATK dhe në Doganën e Kosovës", ka deklaruar Zeka. Nga Zyra e BE-së në Kosovë Hilel Trand ka thënë se Administrata Tatimore e Kosovës është në rrugë të mbarë për t'u modernizuar dhe se është duke luajtur një rol të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Në fund të ceremonisë së shënimit të përvjetorit të 20 janë ndarë edhe çmime për kontribuuesit e mbledhjes së tatimeve si dhe për komunitetin e biznesit, ndër ta edhe një mirënjohje për Odën e Afarizmit të Kosovës.

Thaçi: ATK-ja funksionon në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në shënimin e 20-vjetorit të themelimit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Me këtë rast, Thaçi ka mbajtur një fjalim ku, ndër të tjera, ka thënë se ATK-ja sot funksionon në përputhje me praktikën më të mira perëndimore, duke ofruar shërbime për të gjithë tatimpaguesit. "Sot është një ditë e veçantë ta shënojmë 20-vjetorin e themelimit të Administratës Tatimore të Kosovës. Ky vendim vuri themelet e strukturës që mundëson grumbullimin e tatimeve nga të gjithë në Kosovë. Ta kujtojmë një herë se ku kemi qenë dhe ku kemi arritur tash -

ATK-ja është ndërtuar nga zeroja sikur shumë institucione të Kosovë që kanë arritur suksese të mëdha sot. Bashkërisht me partnerët ndërkombëtarë është dashur të krijohen kapacitetet ligjore për themelimin e kësaj administrate si dhe është dashur të ndërtohet besimi i qytetarëve të Kosovës ndaj ATK-së", ka thënë Thaçi. Ai nuk ka harruar t'i falënderojë partnerët ndërkombëtarë që me përkrahjen e tyre kanë bërë që ky rrugëtim i kësaj administrate të jetë i suksesshëm dhe i sigurt. "Falënderimet e sinqerta shkojnë për USAD-in dhe për partnerët që kanë punuar në UNMIK, BE dhe në FMN. Ndihmua juaj ka

qenë dhe mbetet parësore për suksesin e ATK-së. Një falënderim të veçantë e meritojnë të gjithë qytetarët që kanë punuar gjatë këtyre viteve. Pikërisht përvoja me ndërkombëtarët bëri që vendorët t'i tregojnë përgjegjësitë e tyre më të larta profesionale. ATK-ja sot funksionon në përputhje me praktikën më të mira perëndimore duke ofruar shërbime për të gjithë tatimpaguesit e Kosovës për përmbushje të standardeve më të larta ndërkombëtare. Natyrisht se kanë mbetur ende sfida që duhet të zgjidhen dhe tejkalohen, por ATK-ja është në rrugë të mirë për të arritur edhe më tepër", është shprehur Thaçi.

Afaristët e Mitrovicës dhe të Vushtrrisë shpalosin problemet me të cilat ballafaqohen

MITROVICË, 17 JANAR (ER) - Oda e Afarizmit të Kosovës (OEAQ) ka mbajtur takim me afaristët e Mitrovicës dhe Vushtrrisë në kuadër të ngjarjes "Kafja e mëngjesit", e cila po organizohet në të gjitha qytetet e Kosovës.

Kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skender Krasniqi, ka rikujtuar edhe një herë rekomandimet që i ka bërë Oda për qeverinë e re e cila pritet të formohet. Ai ka përmendur kërkesat për ndryshimin e disa prej udhëzimeve administrative që po dëmtojnë bizneset, të miratuara nga Ministria e Bujqësisë,



Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Krasniqi ka thënë se disa nga ligjet që duhen ndryshuar për të cilat Oda ka ardhur në përfundim se janë të dëmshme për bizneset

në Kosovë janë: Ligji për Miniera dhe Minerale, Ligji i Punës, Ligji për Pushimin e Lehonisë, Ligji mbi TVSh-në, Ligji për Falimentim dhe disa ligje të tjera.

Gjithashtu, Krasniqi ka rekomanduar që të krijohet Ligji për Tregti të Brendshme, të funksionalizohet Ligji për Investime Strategjike me ç'rast do të krijoheshin oferta për bizneset.

Kurse prodhuesi i betonit në Mitrovicë, Mustafë Fazliu, ka thënë se të gjitha pikat e lartpërmendura janë më se të qëlluara e me theks të veçantë ka përkrahur kërkesën e OEAQ-së për ta krijuar Ligjin për Tregti të Brendshme në Kosovë. Po ashtu, ai ka thënë se bizneset duhet të jenë të përfaqësuara më denjësisht në institucione sikur në komunë ashtu edhe në parlament.

Ndërkaq kultivuesja e shpezëve, Qefere Kadriu, është shprehur e pakënaqur me pamundësinë për të eksportuar mish jashtë Kosovës. Sipas saj, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës duhet ta bëjë inspektimin në mënyrë të duhur. E Hatixhe Ibrahimini nga "Agro Koshtova" ka deklaruar se duhet që femrave t'u jepet më shumë përkrahje në biznes. Më tej, Erdall Zasella nga "Royal Group" ka thënë se bizneseve në Mitrovicë nuk duhet t'u ndalohej për të punuar edhe të dielën ngaqë në këtë mënyrë bizneset vetëm po dëmtohen.

Në mungesë të qeverisë, zgjidhja për buxhetin bie mbi Kuvendin



PRISHTINË, 17 JANAR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës mund të gjejnë mënyra për ta miratuar buxhetin për vitin 2020, i cili ka mbetur pezull për shkak të mosformimit të qeverisë së re. Miratimi i buxhetit po shihet si diçka urgjente për shkak të rrezikut që vendi të zhytet në krizë buxhetore nga 1 prilli i vitit 2020.

Hapi i parë që Kuvendi duhet të bëjë, sipas shoqërisë civile, është që t'i formojë komisionet parlamentare në mënyrë që të shqyrtohet korniza aktuale buxhetore.

Qeveria në detyrë e ka përgatitur propozimbuxhetin për vitin 2020 dhe është e gatshme që, sapo të kërkohet, ta procedojë atë në Kuvendin e Kosovës.

Përfaqësues të shoqërisë civile konsiderojnë se Kuvendi i Kosovës, i cili është konstituuar në fund të muajit dhjetor 2019, ka kompetencë ta ushtrojë funksionin e tij legjislativ që, sipas tyre, nënkupton se mund ta miratojë edhe buxhetin e Kosovës.

Drejtoresha e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, Arbresha Loxha, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se Kuvendit i mbetet t'i formojë komisionet parla-

mentare në mënyrë që projektligjin për buxhet të mund ta propozojë ose Qeveria në largim ose Kuvendi përmes iniciativës legjislativë, përkatësisht Komisioni për Buxhet dhe Financa. "Me dorëheqjen e Qeverisë çdo iniciativë ligjore kthehet në pikën zero. Meqenëse deri më tani nuk kemi ende një marrëveshje të arritur nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës për një koalicion qeverisës, Kuvendit i takon përmes iniciativës legjislativë ta propozojë, rrjedhimisht edhe ta miratojë buxhetin e Kosovës", thotë Loxha.

Ministria e Financave tashmë ka deklaruar se më 31 tetor 2019 e ka dorëzuar në qeveri propozimbuxhetin për vitin 2020. Por, qeveria ka qenë në detyrë dhe nuk ka mundur të procedojë miratimin e tij si projektligj, i cili do t'i dorëzohet më pas Kuvendit. Qeveria aktuale apo në detyrë është e zgjedhur nga përbërja e kaluar e Kuvendit që tashmë është shpërndarë dhe është formuar kuvendi i ri.

Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit në detyrë të Financave, Bedri Hamza, konsideron se qeveria në dorëheqje mund të procedojë në Kuvend,

Projektligjin për buxhet. Ai thotë se Gjykata Kushtetuese nuk e ka kufizuar asnjë kompetencë të qeverisë. Në të kundërtën, procedimi i projektligjit mund të iniciohet ose nga komisionet, grupet parlamentare ose edhe deputetët, thotë ai. "Qeverisë, tashmë në detyrë, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk i është kontestuar statusi. Dhe nuk kemi asnjë ligj ose rregullore që njej definicionin qeveri në dorëheqje apo qeveri në detyrë. Krejt kjo po vjen si pasojë e mungesës së ligjit të qeverisë. Qeveria pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese është duke marrë vendime dhe nuk po i kontestohet asnjëherë vendimmarrja", thekson Rafuna.

Më 19 korrik Ramush Haradinaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministrit të Kosovës. Dorëheqja e tij pasoi ftesën që kishte marrë nga Gjykata Speciale e Kosovës me seli në Hagë, ku ishte ftuar për një intervistë në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte. Më pas, Haradinaj i ishte drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën që t'ia definonte përgjegjësitë gjatë kohës sa ai dhe qeveria në largim do të

funksiononin në dorëheqje.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka cilësuar të papranueshme për interpretim kërkesën e Haradinajt lidhur me definimin e kompetencave dhe funksionimit të qeverisë pas dorëheqjes së kryeministrit. Duke besuar se edhe me qeverinë në dorëheqje, Kuvendi mund ta miratojë buxhetin, Rafuna thotë se me krijimin e qeverisë së re ajo në çdo kohë mund ta rishikojë dhe përmirësojë buxhetin. "Qeveria e ardhshme, nga kushdo që krijohet, ka mundësi që në çdo kohë mund të rishikojë dhe rregullojë buxhetin e Kosovës", thekson ai.

Disa sindikata në Kosovë kanë kërkuar nga kryeministri në detyrë që ta dërgojë në Kuvend Projektligjin për buxhet për vitin 2020, me qëllim, siç është thënë, shmangies së trazirave sociale. Këto shqetësime përfaqësues të Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Federatës Sindikale të Shëndetësisë dhe Sindikatës së Policisë së Kosovës i kanë shprehur pasi që janë takuar me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, duke kërkuar që ai të angazhohet për ndërmarrjen e hapave ligjorë për aprovimin e buxhetit.

Në një komunikatë të Kuvendit të Kosovës thuhet se kryetari Glauk Konjufca ka theksuar se po punon për ndërtimin sa më të shpejtë të institucioneve, duke i hapur kështu rrugë edhe miratimit të Ligjit për buxhetin. Ai ka theksuar angazhimin e tij maksimal për të ardhur deri te një zgjidhje, e cila do ta shmangte rrezikun e mbetjes pa paga të punonjësve të sektorit publik.

Aktualisht, me autorizimet ligjore, Ministria e Financave ka bërë zgjatjen e ndarjeve buxhetore dhe alokimin e mjeteve për organizatat buxhetore për dy muajt e parë të vitit 2020. Kurse për muajin mars besohet se vetëm Kuvendi mund të vendosë për vazhdimin e këtij vendimi apo zgjatjen e ndarjeve buxhetore. Kjo është koha përfundimtare e lejuar për shpenzim buxheti dhe nuk ka asnjë instrument tjetër ligjor që ndarjet buxhetore të shtyhen më shumë se tre muaj, pra jo më vonë se data 31 mars 2020. Pas kësaj date, Kosova futet në krizë buxhetore, pasi asnjë organizatë buxhetore ose autoritet tjetër publik nuk mund të autorizojë asnjë shpenzim ose pagesë derisa të miratohet ligji i ri për ndarjet buxhetore.

Së shpejti fermerët do ta kenë mundësinë t'i sigurojnë produktet e tyre bujqësore

Prishtinë, 17 janar (ER) - Së shpejti fermerët në Kosovë do të kenë mundësi që t'i sigurojnë produktet e tyre bujqësore te kompanitë e sigurimit në

Kosovë. Për këtë është diskutuar nga drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, gjatë takimit me përfaqësuesit e IFC-së. "Sot me

përfaqësuesit e IFC-së kemi diskutuar për zbatimin e mëtejshëm të Projektit të Sistemit të Sigurimeve Bujqësore në Kosovë për vitin 2020, ku së

shpejti fermerët do ta kenë mundësinë që t'i sigurojnë produktet e tyre bujqësore te kompanitë e sigurimit në Kosovë", ka bërë me dije Mazreku.



Gjobiten disa markete në Kamenicë për produkte me afat të skaduar

KAMENICË, 17 JANAR (ER) - Inspektorati Komunal gjatë punës në terren ka inspektuar të gjitha marketet e mëdha, të mesme dhe të vogla në Komunën e Kamenicës. Gjatë inspektimit të këtyre marketeve, Inspektori Sanitar dhe Veterinar në pesë markete në Kamenicë ka asgjë-

suar mall me afat të skaduar në vlerë mbi 200 euro si dhe janë gjobitur disa markete, ku vlera e një gjobe arrin në 400 euro. Inspektorati Komunal u ka bërë thirrje të gjitha marketeve që të kenë kujdes dhe të mos mbajnë produkte pa afat të cilat mund ta dëmtojnë shëndetin e konsumatorëve.

Shefi i Inspektoratit në Kamenicë, Liridon Beqiri, ka thënë se inspektorati gjatë këtij viti do të jetë shumë aktiv. "Inspektorati do të jetë aktiv duke inspektuar të gjitha bizneset të cilat nuk respektojnë ligjet dhe do të shqiptohen gjoba për ta", ka thënë Beqiri.



Ismajli: Abdullah Tahiri u flijua për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës

GJILAN, 17 JANAR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, së bashku me kryesuesen e Kuvendit Komunal, Shpresa Kurteshi-Emini dhe drejtorët komunalë, kanë bërë homazhe te lapidari i heroit të kombit Abdullah Tahiri, në Malishevë të kësaj komune. Me këtë rast, Ismajli ka thënë se Abdullah Tahiri është flijuar për lirinë e Kosovës. "Këtë vit 'Flaka e Janarit' i kushtohet dëshmorit të kombit Abdullah Tahiri, i cili u flijua për lirinë, pavarësinë dhe çlirimin e Kosovës.

Tash e tutje ai do të jetë në piedestalin më të lartë të lirisë, pasi do të vendoset shtatorja e tij sivejt, në vendin ku është arrestuar. Është një nga figurat më të rëndësishme historike jo vetëm të Anamoravës, por të gjithë popul-

lit shqiptar. Lavdi e përgjeshme veprës së tij", ka deklaruar Ismajli. Ndërsa kryetari i kësaj bashkie Malishevë, Latif Maliqi, ka falënderuar kryetarin Haziri që manifestimin "Flaka e Janarit 2020" ia ka dedikuar heroit Abdullah Tahiri. Ndërkohë, nënkryetari Ismajli ka vizituar edhe familjen e heroit Kadri Zeka, në 38-vjetorin e rënies, ku është pritur nga Shaip Zeka.

Ismajli në emër të kryetarit Haziri ka konfirmuar se sivejt do të vendoset edhe shtatorja e heroit Kadri Zeka në një vend meritore në Gjilan. Përfaqësuesi i familjes Zeka, Shaip Zeka, e ka falënderuar kryetarin Haziri dhe nënkryetarin Ismajli për nderin që ia kanë bërë familjes së tij me vizitën dhe lajmin për vendosjen e shtatores.



Hysni dhe Nakije Gashi ndajnë pensionin e pleqërisë për fëmijët jetimë



MALISHEVË, 17 JANAR (ER) - Hysni Gashi, ndër profesorët e parë që ka punuar në gjimnazin e Malishevës, në fillimvitet gjashtëdhjetë, jo vetëm se ka kontribuar në arsimimin e gjeneratave të reja, por edhe sot në moshën 86-vjeçare bashkëjeton me malishevasit, në veçanti me familjet që kanë nevojë sociale. Për këtë kategori të shoqërisë ai me bashkëshorten e vet, Nakijen, ka vendosur ta ndajnë pensionin e pleqërisë. Deri më tash ai për këto familje ka ndarë 1 350 euro, ndërsa shpërndarjen e këtyre mjeteve e ka bërë personi përgjegjës në Komunën e Malishevës. Kryetari i Komunës së

Malishevës, Ragip Begaj, në emër të komunës dhe familjeve skamnore ka falënderuar Hysni dhe Nakije Gashin për kontributin e tyre. "Ju dje ishit ndër profesorët e parë që hapët dritaren e arsimit shqip në Komunën e Malishevës, sot po hapni dritaren e humanizmit, duke ndarë pensionin tuaj për familjet malishevase në nevojë e veçmas për jetimët edhe në këtë moshë të shtyrë, prandaj si ish-nxënës i juaji dhe kryetar komune, ju jam mirënjohës për veprën e madhe humane që po bëni për qytetarët e Malishevës", është shprehur Begaj. Hysni dhe Nakije Gashi do të vazhdojnë t'i ndihmojnë familjet skamnore malishevase, veçmas jetimët.

Shpërndahen fletushka informative për parandalimin e lëmshës në kryeqytet

PRISHTINË, 17 JANAR (ER) - Komuna e Prishtinës dhe Policia e Kosovës kanë bërë shpërndarjen e fletushkave informative për parandalimin e dukurisë së kërkimit të lëmshës në kryeqytet. Kjo komunë ka njoftuar se kanë hartuar edhe programe të

ndryshme për parandalimin e kësaj dukurie shqetësuese. "Komuna e Prishtinës ka të hartuar programe dhe politika të veçanta për ta trajtuar këtë dukuri dhe kategori shoqërore. Kohë më parë, në bashkëpunim me 'Terre des hommes-Kosovo', kemi funksionalizuar

qendrën ditore për fëmijët në situatë rrugë, duke qenë se është grupi më i cenueshëm i kësaj kategorie. Falënderojmë Policinë e Kosovës dhe partnerët e tjerë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (4)

Fusha magnetike e përçuesit brenda solenoidit



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Duke u bazuar në eksperimentet e mëparshme, që tregohet se gjilpëra magnetike tregojnë se ekzistojnë dy pole magnetike, të cilat pole nuk mund ta kenë origjinën vetëm nga elektronet ashtu sikur e tregojnë fizika, sepse këtë nuk e lejon natyra. Në këtë mënyrë dy polet magnetike e kanë origjinën si nga protonet e ngarkuara pozitivisht, ashtu edhe nga elektronet e ngarkuara negativisht, por që ndihmohen edhe nga neutronet.

Në këtë mënyrë vijmë në përfundim se së pari nga poli magnetik i jugut (S) krijohet nga fusha elektrostatike e elektroneve, kurse poli magnetik i veriut (N) krijohet nga fusha antielektrostatike e elektronit, kurse së dyti poli magnetik i Veriut (n) krijohet nga fusha elektrostatike e protoneve, kurse poli magnetik i jugut (S) krijohet nga fusha antielektrostatike e protonit.

Në këtë mënyrë nga protonet dhe elektronet burojnë njëkohësisht katër fusha, ku dy janë elektrostatike dhe dy fusha antielektrostatike. Por këto katër fusha elektrostatike dhe antielektrostatike shkrihen në dy fusha magnetike të secilit magnet apo elektromagnet ashtu sikur shihen në figurën 3. e). Ku secila fushë magnetike përmban nga dy fusha në brendinë e sajë, të cilat fusha kanë drejtime të kundërta dhe intensitete të ndryshme.

Meqenëse rryma elektrike krijohet njëkohësisht nga protonet, elektronet dhe neutronet, atëherë vijmë në përfundim se edhe rrjedhja e kësaj rryme nëpër solenoid krijon në secilin poli magnetik nga dy fusha magnetike me intensitet të ndryshme, burimi i të cilave fushave ka drejtime të kundërta me njëra tjetrën. Prandaj poli i veriut (N) i gjilpërës magnetike orientohet në drejtim të polit magnetik të veriut (N) të fushës magnetike brenda solenoidit, kurse poli magnetik i jugut (S) të gjilpërës magnetike orientohet në drejtim të polit magnetik të veriut (N) të fushës magnetike të solenoidit.

Përkufizim

Brenda një solenoidi nëpër të cilin rrjedhë rryma elektrike në secilin skaj të solenoidit burojnë nga dy fusha magnetike me intensitete të ndryshme, që krijohen nga fushat elektrostatike dhe antielektrostatike të elektronit dhe protonit. Në këtë mënyrë themi se nga secili magnet permanent apo elektromagnet burojnë njëkohësisht katër fusha magnetike, kjo i bie se nga secili poli i magnetit apo elektromagnetit burojnë nga dy fusha magnetike.

Fusha magnetike

Tani për ta vërtetuar apo kundërshtuar një fushë magnetike të cilën e njeh e tërë shkenca që nga kohërat e lashta e deri në ditët e sotme, ne do t'i drejtohem kësaj natyre, me eksperimente të kryera në këtë natyrë, ne do ta vërtetojmë se a ekziston me të vërtetë një fushë magnetike që lëviz nëpër një rrugë të mbyllur, dhe gjithmonë ka një drejtim të lëvizjes, sidomos atë nga poli magnetik i veriut (N) në drejtim të polit magnetik të jugut (S) ashtu sikur u cek më lart, apo ekzistojnë në vend të një fushe magnetike dy e më shumë fusha magnetike.

Eksperiment 2

E marrim një magnet në formë cilindrit (M) i cili ka një vrimë që tejkalon nëpër të me rreze të caktuar (r) ashtu sikur shihet në figurën 4. a) në vazhdim.

Afër skajit të brendshëm, mbi polin magnetik të jugut (S) prej nga shkenca mendon se hyn fusha magnetike që buron nga poli magnetik i veriut (N), e lëshojmë në gjendje të lirë një sferë të magnetizuar (m). Do të shohim se sfera e magnetizuar sapo të arrijë në mes të cilindrit, përkatësisht në mes poleve magnetike brenda cilindrit, sfera e magnetizuar (m) ndalon dhe nuk shkon më tutje nga poli magnetik i veriut. Madje kjo sferë mund të largohet nga mesi i magnetit cilindrik vetëm në veprimin e një forcë të jashtme.

Argument

Tani supozojmë një dipol magnetik (dm) në vend të sferës së magnetizuar (m) i cili lëvizë nga poli magnetik i jugut (S) në drejtim të polit magnetik të veriut (N).

Shtrohen pyetjet: 1. Si është e mundshme që një dipol magnetik (dm1) që hyn nga poli magnetik i jugut (S) dhe




Fig. 3e




Fig. 4a




Fig. 4b




Fig. 4c

ndalon në mes të magnetit, dhe nuk shkon dipoli në drejtim të polit magnetik ashtu sikur shkenca e njeh? 2. Nëse sferën magnetike nevojitet një forcë (F) për ta nxjerrë nga brendia e magnetit cilindrik, në drejtim të polit magnetik (N) dhe të rrotullohet dhe të hyjë në polin magnetik (S), atëherë cila është ajo forcë që e detyron dipolin magnetik (dm1) të largohet nga mesi i magnetit e

të niset në drejtim të polit magnetik (N).

Pasi duhet një forcë për ta nxjerrë sferën e magnetizuar (m) nga mesi i magnetit cilindrik (M), gjithashtu duhet edhe një forcë për ta vërë në lëvizje dipolin magnetik (dm) drejt polit magnetik (N).

Eksperiment 3

Tani për dallim nga eksperimenti i dytë, në këtë rast i rro-

tullojmë polet e magnetit cilindrik, ku në vend të polit magnetik të jugut (S) të magnetit cilindrik (M), vije poli magnetik i veriut (N) dhe anasjelltas. Ashtu sikur më parë edhe në këtë rast sferën e magnetizuar e lëshojmë në brendi të polit magnetik të veriut (N) të magnetit cilindrik (M). Edhe në këtë rast do të vërtetohet tërësisht ngjashëm sikur në rastin e parë, sfera sapo të arrijë në mesin e magnetit ajo do të ndalon, dhe nuk shkon tutje në drejtim të polit magnetik të jugut (S) ashtu sikur shihet në figurën 4. b).

Lidhshmëria në mes eksperimentit dy dhe tre

Po t'i bashkojmë të dy eksperimentet në një eksperiment të vetëm, duke supozuar se dy sferat e magnetizuara (m1) dhe (m2) i afrojmë në të dy polet magnetike (N) dhe (S), do të shohim se të dy sferat e magnetizuara lëvizin në drejtim të qendrës së magnetit, dhe ndalojnë aty në të njëjtin vend të dyja. Çka do të thotë se sferat në brendësi të magnetit lëvizin në drejtime të ndryshme, me ç'rast në eksperimentin e dytë sfera e magnetizuar lëviz nga poli magnetik i jugut (S) në drejtim të polit magnetik të veriut (N), kurse në eksperimentin e tretë sfera e magnetizuar lëviz nga poli magnetik i veriut (N) në drejtim të polit magnetik të jugut (S). Por në të dy eksperimentet sferat ndalojnë në mes të magnetit, dhe aty mbesin të bashkuara të dy sferat e magnetizuara ashtu sikur shihen në figurën 4. c). Këto sfera mbesin të bashkuara në brendi të magnetit për derisa në to nuk vepron ndonjë forcë e jashtme që i nxjerr nga brendësia. (VIJON)

Betohen senatorët, gjyqi ndaj presidentit Trump vazhdon të martën

Senati i dërgoi një njoftim me shkrim presidentit Donald Trump të enjten, duke e njoftuar për gjyqin dhe akuzat ndaj tij dhe ai duhet të përgjigjet me shkrim brenda mëngjesit të së shtunës. Për ta shpallur atë fajtor për secilën nga dy akuzat, nevojiten votat e 2/3 të senatorëve

WASHINGTON, 17 JANAR - Njerëzit e përfshirë në procesin e gjyqimit të presidentit Donald Trump në Senat kanë përpara një fundjavë të gjatë për të reflektuar rreth roleve dhe përgjegjësi të tyre falë festës kombëtare amerikane të Martin Luther Kingut. Senati i dërgoi një lajmërim me shkrim presidentit Trump të enjten, duke e njoftuar për gjyqin dhe akuzat ndaj tij dhe ai duhet të përgjigjet me shkrim brenda mëngjesit të së shtunës. Gjyqi për shkarkimin e presidentit Trump vjen në kohë ndasish të thella në vend dhe ndërsa

demokratët po konkurrojnë për të kandiduar përballë tij në zgjedhjet e ardhshme presidenciale, ka njoftuar vova. Zyra për Llogaridhënien e Qeverisë (GAO), një entitet që mbikëqyr Qeverinë amerikane, konkludoi të enjten se presidenti Trump shkeli ligjin buxhetor vitin e kaluar kur pezulloi ndihmën ushtarake për Ukrainën prej 391 milionë dollarësh që kishte miratuar Kongresi. Në të njëjtën kohë, ai i bëri presion Kievit të fillonte hetime që do ta ndihmonin atë politikisht. Ky vendim lidhet me thelbin e pro-

cesit për shkarkimin e presidentit Trump.

Ndihmën që i duhej Ukrainës për luftën ndaj separatistëve pro-rusë në pjesën lindore të vendit, presidenti Trump e zhbllkoi në shtator, pas 55 ditësh vonesë, dhe pa përfutur çeljen e hetimeve nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskiy ndaj njërit prej sfidantëve kryesorë demokratë, ish-nënpresidentit Joe Biden, si dhe ndaj djalit të tij, Hunter Biden, i cili kishte qenë anëtar bordi i një kompanie ukrainase të gazit.

Por pas hetimit, Zyra për Llogaridhënien e Qeverisë (GAO) konkludoi se "zbatimi i përpiktë i ligjit nuk i lejon presidentit që prioritetet e politikave që Kongresi i ka përcaktuar me ligj, t'i zëvendësojë me përparësitë e politikave të tij". Në raport përcaktohet se agjencia buxhetore, e kontrolluar nga presidenti Trump, bllokoi livrimin e fondeve "për arsye poli-

tikash", gjë që nuk e lejon ligji amerikan.

Vendimi i GAO-s u bë publik vetëm dy orë përpara fillimit zyrtar të gjyqit në Senat, ku janë ngritur dy akuza: se presidenti Trump abuzoi me postin duke u përpjekur ta detyrojë presidentin ukrainas Zelenskiy të çelë hetime ndaj Joe dhe Hunter Biden, ndërkohë që kishte pezulluar ndihmën ushtarake; si dhe se pengoi përpjekjet e Kongresit për t'i hetuar veprimet e tij në Ukrainë.

Shtatë ligjvënës, të emëruar si prokurorë të çështjes kundër presidentit Trump, i paraqitën solemnisht akuzat gjatë një leximi në mesditën e së enjtes në Kapitol. Kryetari i Komisionit të Zbulimit të Dhomës së Përfaqësuesve, Adam Schiff, lexoi akuzat ndaj presidentit të 45-të të Shteteve të Bashkuara, në një seancë të zhvilluar vetëm tri herë në historinë prej dy shekujsh e gjysmë të Senatit

amerikan.

Ligjvënësit-prokurorë nga Dhoma e Përfaqësuesve duhet të përgatisin dhe të paraqesin argumentet ligjore të shtunën dhe të hënën.

Kryetari i Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara, John Roberts, bëri betimin për të marrë drejtimin e gjyqit ndaj presidentit Trump. Pak minuta më vonë, u betuan përpara tij 99 nga 100 senatorët, të cilët do të shërbejnë si juri që do të vendosë për fatin e presidentit Trump. Mungonte vetëm senatori James Inhofe, i shteti Oklahoma, për shkak të një emergjence familjare. Ai do ta bëjë betimin javën e ardhshme, kur të ketë filluar gjyqi. Formula e betimit të ligjvënësve thotë se ata angazhohen të japin "drejtësi të paanshme". Sidoqoftë, një numër i madh senatorësh e kanë deklaruar tashmë votën e tyre, nëse do të jetë për fajësinë apo pafajësinë e presidentit Trump.

Pas kësaj pjese përgatitore, gjyqi "i vërtetë" pritet të fillojë të martën e ardhshme, në orën 1 pasdite, në sallën e Senatit.

Zyra për Menaxhimin dhe Buxhetin, po kështu edhe Shtëpia e Bardhë, e hodhën poshtë konkluzionin e GAO-s. "Nuk jemi dakord me opinionin e GAO-s, zyra jonë ushtron autoritetin e saj për caktimin e fondeve, për t'u siguruar që dollarët e taksapaguesve të shpenzohen në përputhje me përparësitë e presidentit dhe me ligjin", tha një zëdhënës i Zyrës për Menaxhimin dhe Buxhetin. Duke qenë se republikanët kanë shumicën në Senat (53 me 47), është pothuajse e sigurt që presidenti Trump do të dalë i pafajshëm dhe do të vazhdojë detyrën. Për ta shpallur atë fajtor për secilën nga dy akuzat, nevojiten votat e 2/3 të senatorëve. Disa republikanë kanë kritikuar përpjekjet e presidentit Trump për të hapur hetime ndaj zotërinjve Biden.

Por, asnjë republikan nuk ka bërë thirrje për shpalljen e tij fajtor dhe heqjen nga detyra, ndërsa jemi vetëm më pak se një vit larg momentit kur ai do të përballet me votuesit për një mandat të dytë në Shtëpinë e Bardhë.



Kryeministri i Ukrainës jep dorëheqje

KIEV, 17 JANAR - Kryeministri i Ukrainës dha dorëheqje të premtën pas publikimit të një audio-regjistrimi gjatë të cilit ai dëgjohet duke bërë komente denigruese ndaj presidentit lidhur me atë se sa e kupton Zelenskiy ekonominë. Në një postim në "Facebook", Oleksiy Honcharuk

shkruante se ai mori detyrën e kryeministrit për ta përmbyshur programin e presidentit, duke e quajtur atë "model të sinqeritetit dhe moralit".

Duke iu referuar përgjimit të publikuar Honcharuk tha se "për të hequr çdo dyshim në lidhje me respektin dhe besimin tonë të

presidenti, paraqita një letër dorëheqje dhe presidenti do ta paraqesë atë në parlament".

Volodymyr Zelenskiy pritet të rishikojë letërën e dorëheqjes e më pas do të shpallë vendimin, thuhej në një deklaratë të zyrës së presidentit, të publikuar nga agjencia e lajmeve ukrainase, UNIAN.




'Bardhësitë e Atdheut'- Enciklopedia gjithkombëtare me, 30 mijë dëshmi dhe dokumente gjithkombëtare të Atdheut...

Përkthimi i Enciklopedisë, tashmë me mijëra fakte, fotografi, historiografi, biografi të dëshmorëve, heroinave, heronjve dhe martirëve, dokumente dhe argumente 200-vjeçare është domosdoshmëri dhe interes i veçantë publik gjithkombëtar...

Nga: Ekipi Hulumtues, Dokumentues, Botues dhe Promovues i Enciklopedisë Gjithkombëtare, "Bardhësitë e Atdheut"

Enciklopedia e trojeve shqiptare, "Bardhësitë e Atdheut", tashmë ka



Gjeneral-lejtnant, Agim Çeku



Autori, Afrim Mustafa



Ish-Kryeministri, Dr. Bajram Rexhepi



Ish-eporri i Lartë i UÇK-së, Elmi Reçica

drejtpërdrejtë nga vatrat e luftës për liri, qysh nga prilli i vitit 1998, nga Gllanasella, Prekazi, Likoci, Qirezi, Likoshani, Prelloci, Dobrosheci, por edhe nga Nerodimja, si nga : Jezerci, Gabrrica, Kaçaniku, Elezaj, Stagova, Biçeci, Brodi, Firaja, Gremja, Komogllava, Gërlica, Soponica, Runjeva, e posaçërisht

manisht, italisht, frengjisht, kroatisht, spanjollisht, maqedonisht dhe serbisht... Por, deri tash, asnjë përkrahje financiare nga asnjë institucion qendror, e as lokal... Këto ditë, po ashtu gjatë një promovimi me bashkëlufetarë dhe bashkëveprimtarë është kërkuar që institucionet e Republikës së

me duart e tyre, folën dhe flasin flasin për Enciklopedinë, e cila tashmë përfshin: 30 mijë dokumente, dëshmi dhe argumente gjithkombëtare, nga Lidhja e Prizrenit, e deri më 14 dhjetor 208, kur u themelua, Ushtria e Republikës së Kosovës... Si: Gjeneralmajor, Agim Çeku, ish-

Operative e Karadakut, Abdyl Bajrami, ish- eporri nga LLapi dhe Gollaku, Shefki Rashit Rashiti, veprimtari nga Muzeqina e Ferizajt, Agim Osmani, i cili gjendet në mërgim, në Suedi, motra e çlirimtarit të paepur të Koshares trime, Qazim Ilaz Shehu nga Shkupi, Kosovare Shehu, veprimtari dhe drejtori i Policisë Rajonale në Ferizaj, Emin Beqiri, të bijat e dëshmorit të Kombit, Hazir Azem Hajdini nga Prapashtica e Prishtinës, Ardiana dhe Majlinda Hajdini, eporri i Policisë së Kosovës në Viti, mr. Bulent Zenuni, gazetari i shquar nga Kosova, në SHBA, Lulzim Msjulliqi, vëllai i dëshmorëve të kombit: Tomë dhe Zef Rrok Gjokaj, nga Dashinoci i Gjakovës, Pren Gjokaj, bashkëlufetarë nga Tërpeza e Malishevës, Bekim Krasniqi, me punë në Itali, i riu entuziast nga Lipjani, Flamur Ibrahimimi ... Promovimet dhe Nderimet e Enciklopedisë gjithkombëtare, "Bardhësitë e Atdheut", me autor, z. Afrim Mustafa, vazhdojnë...



Ardiana dhe Majlinda, dy bijat e dëshmorit, Hazir Azem Hajdini nga Prapashtica



Mr. Bahri Gashi, Dr. Fahrush Rexhepi dhe Dr. Agim Zogaj

përrjetuar disa ribotime dhe mbi 340 promovime, në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, por edhe nëpër disa vende në diasporë. Autori nderuar, z. Afrim Mustafa, i cili gjatë luftës veprroi reporter i

nga Ivaja, Gajre, Pusteniku, Kotlina, Kovaçeci, Gllaboçica, tregon se, pas qindra promovimeve anekënd shqiptarisë, tashmë është i preokupuar për përkthimin e enciklopedisë në anglisht, gjer-

Kosovës ta financojnë urgjentisht ribotimin dhe përkthimin e Enciklopedisë gjithkombëtare, "Bardhësitë e Atdheut"... Personalitete të ndryshme gjithkombëtare, duke promovuar

komandanti i shquar i UÇK-së, tash njëri nga deputetët më të votuar në Republikën e Kosovës, Elmi Reçica, ish- kryeministri i parë i Republikës së Kosovës, dr. Bajram Rexhepi, ish-themeluesi i UÇK-së, Zona



Drejtori i Policisë Rajonale të Ferizajt, Emin Beqiri



Eporri i Lartë i Policisë së Kosovës, Refki Morina




Luftëtari i UÇK-së nga Tërpeza e Malishevës, tash në Itali, Bekim Krasniqi




Kosovare Shehu nga Shkupi, motra e veteranit emblematik të UÇK-së, Qazim Ilaz Shehu



Gazetari i shquar nga Kosova, në Shba, Lulzim Muliqi



Veprimtari nga Muzeqina e Ferizajt në Suedi, Agim Osmani



Pren Rrok Gjokaj, vëllai i dy dëshmorëve: Tomë dhe Zef Rrok Gjokaj



Një nga eporret e Policisë në Viti, Mr. Bulent Zenuni



Një nga çlirimtarët e hershëm, ish eporri i UÇK në Llap dhe Gollak, Shefki Rashit Rashiti



I riu entuziast nga Lipjani, me enciklopedinë "Bardhësitë e Atdheut" në duar: Flamur Ibrahimimi

E rrallë

Burri rrezikon pesë vjet burgim pasi iu gjetën 20 zogj në valixhe

Një shtetas belg u arrestua në aeroportin e Limas në Peru pasi në valixhen e tij iu gjetën 20 zogj të gjallë. 54-vjeçari u përpoq t'i trafikonte zogjtë duke i fshehur brenda në kuti të vogla. Zogjtë, një lloj specie e mbrojtur që do të shiteshin në Madrid, kishin



qëndruar disa orë brenda në kuti të mbyllur. Burri i arrestuar rrezikon të dënohet me pesë vjet burgim për akuzën e trafikut të kafshëve të egra.

FOTO E DITES



Në Kabul disa persona shihen ulur rreth një zjarri duke u ngrohur pas reshjeve të borës. /AP/

E jashtëzakonshme

Thyhet rekordi Guinness, njihuni me përmasat e tortës 27 tonë

Rekordi Guinness për tortën me përmasa më të mëdha në botë është vendosur së fundmi në Indinë e Jugut. Torta e gjatë 6 kilometra e gjysmë është e trashë 10 centimetra dhe peshon 27 tonë. U deshën rreth 1 500 pas-triçerë për të bërë një tortë për Guinness. Një



riip shumë i gjatë me tortë sfungjeri u shtrua në dhjetëra tavolina të rregulluara në qytetin e Thrissur, kryeqyteti kulturor i Keralas, në jug të Indisë.

BARSOLETA E DITËS



Gjykatësi: Pse e vodhët bankën? I pandehuri: Dëshironi t'jua them të vërtetën?
Gjykatësi: Sigurisht.
I pandehuri: E vodha sepse ajo filloi e para të më vjedhë!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Disa konflikte mund të lindin pikërisht me


njerëzit që ju doni më shumë. Pa dyshim se nuk ka mungesë dashurie, por nuk është gjithmonë e lehtë ta kuptosh njëri-tjetrin.



DEMI

Yjet do t'i shpërblejnë sakrificat tuaja, gjithashtu

nga një këndvështrim financiar: vazhdoni në rrugën e mbarë!



BINJAKËT

Ju mund ta prekni qiellin me një gisht, nëse keni

një marrëdhënie emocionale të qëndrueshme dhe të lumtur.



GAFORRJA

Mos kini frikë ta hapni sirtarin e ëndrrave

dhe iluzioneve tuaja. Ndonjëherë ato vijnë vërtet! Flini më gjatë, pushoni sa më shumë që të jetë e mundur.



LUANI

Do të jeni aq bindës sa të gjithë do ta ofrojnë

mbështetjen e tyre. Faleminderit Hënës në Peshore dhe Venusit në Peshqit që do t'i ngrenë kuotat tuaja sot edhe në fushën sentimentale.



IRGJËRESHA

Do të keni një dhuratë të

pakëndshme nga Marsi në Shigjetar, do të jeni në një pozicion armiqësor. Shmangni gabimet.



PESHORJA

Ka disa probleme që po ju stresojnë

kohët e fundit, por kalimi i Mërkurit tek Ujori tregon se gjërat me siguri do të përmirësohen.



AKREPI

Është më mirë ta zgjidhni kohën dhe

mënyrën e duhur për të vepruar. Sa i përket dashurisë, ju ndiheni të hutuar.



SHIGJETARI

Mundësitë nuk do të mungojnë! Nëse, nga

ana tjetër, tashmë jeni në një marrëdhënie, mos u shtrëngoni shumë, mos e ngacmoni xhelozinë e partnerit tuaj!



BRICJAPI

Kështu që ju mund të kujdeseni

për partnerin tuaj, mirëqenien tuaj fizike, një temë që ju duket shumë tërheqëse.



UJORI

Ju jeni të pajisur me qetësi dhe opti-

mizëm që do t'ju bëjë të shikoni përpara me vendosmëri! Nëse marrëdhënia funksionon, ju do të jeni afër parajsës.



PESHQIT

Në fushën profesionale, mos i

përbuzni projektet me përmasa të gjera: është koha juaj, madje edhe ëndrrat më të guximshme kanë mundësinë e kthimit në realitet konkret.

Dua Lipa paralajmëron këngë të re



Këngëtarja e njohur me prejardhje nga Kosova, Dua Lipa, ka bërë me dije se shumë shpejt do ta publikojë këngën më të re. Ajo me anë të një postimi në

rrjetin social "Instagram" u shpreh: "Shumë shpejt muzikë të re në galaktikën më të afërt tuajën". Lipa në këtë fotografi duket e bukur dhe tërheqëse.

Selena Gomez bën tatuazh emrin e albumit më të ri



Këngëtarja e njohur Selena Gomez ka bërë një tatuazh të ri në qafën e saj. Ky tatuazh ka një veçanti për këngëtarën pasi është emri i albumit të saj më

të ri, shkruan "People". "Rare" është tatuazhi më i ri i Gomezit, i cili mori shumë pëlqime nga adhuruesit e saj në rrjetin social "Instagram".



Lindsay Lohan thotë se albumi i saj po vjen në fund të shkurtit


Çfarë po presin fansat e Lindsay Lohan? Lindsay Lohan ka njoftuar se albumi i saj i ri "LL3" do të dalë në fund të shkurtit. Këngëtarja 33-vjeçare e zbuloi këtë duke iu përgjigjur

një fansi në "Instagram". Fansi shkroi: "Shpresoj se do të kemi LL3 këtë vit" duke e postuar një fotografi të këngëtares në skenë. Kjo e fundit ia konfirmoi.

Pas 27 vjetësh Al Pacino sërish nominohet për Oscar

Aktori i njohur Al Pacino për herë të parë pas 27 vjetësh sërish është nominuar për Oscar. Ai për "People" ka treguar si ndihet për këtë nominim të tij pas kaq kohe. "Kanë qenë shumë llafe që ka mundësi të

nominohem për Oscar, por kur dëgjova dhe më thanë 'je nominuar', ishte diçka që më bëri të ndihem shumë mirë", u shpreh ai. Al Pacino ishte shpallur fitues si Aktori më i Mirë edhe në ceremoninë e Oscar të vitit 1993.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Ngritja e madhe e Rrahmanit nga Drenica te Napoli

Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, ka bërë hapin më të madh në karrierë, duke nënshkruar kontratë pesëvjeçare me Napolin. 25-vjeçari brenda nëntë vjetësh arriti nga futbollit i izoluar i Kosovës transferimin në njërin prej kampionateve më të fortë në botë, Serinë A. Përzgjedhësi i Kosovës, Bernard Challandes, ka vlerësuar se klubi italian ka bërë një blerje të shkëlqyeshme, derisa futbollisti do të fitojë 1.8 milion euro në sezon

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 JANAR - Në vitin 2011 futbollit i Kosovës ishte i izoluar dhe skuadrat zhvillonin gara vetëm në rrafshin vendor dhe në këtë kohë doli në skenë ylli Amir Rrahmani, i cili brenda nëntë vjetësh arriti kulmin duke kaluar në njërin prej kampionateve më të fortë në botë, Serinë A. Mbrojtësi luajti dy vjet për skuadrën kuqezi nga Skenderaj, ku u paraqit në 40 ndeshje dhe realizoi një gol. Paraqitjet e mira të Rrahmanit ndikuan që ai më pas të kalojë në Partizanin e Tiranës për të luajtur mbi 50 ndeshje zyrtare. Shtatlarti për klubin shqiptar realizoi tre gola dhe më pas arriti të transferohet në Kroaci, por fillimisht në një klub jo shumë të fortë si Spliti, por më pas Rrahmani ka luajtur për Lokomotivën dhe Dinamon e Zagrebit. Falë paraqitjeve superiore me klubin kroat, Amir Rrahmani bëri hapin e madh, duke u transferuar në Serinë A, konkretisht te skuadra e ngritur në rangun elitare të futbollit italian, Hellas Verona. Paraqitjet e mira në shtatëmbëdhjetë ndeshje me këtë klub e tërheqjen interesimin e shumë klubeve, por shqiptari nga Kosova vendosi ta pranonte ofertën e Napolit derisa kreu të premten testet mjekësore. Verona e bleu kartonin e Rrahmanit nga Dinamo për 2 milionë dhe e shiti për 15 milionë, derisa mbrojtësi do të paraqitet për Veronën deri në fund të kampionatit dhe në verë do t'i bashkohet Napolit. Menaxheri i Rrahmanit, Adrian Alijaj, është shprehur i lumtur për futbollistin, por edhe për vetën si menaxher që kanë arritur marrëveshje me një klub siç është Napoli. "Të vish në këtë nivel për të pasur interesim nga Napoli është privilegj për lojtarin dhe mua si menaxher. Është punë e vështirë, sakrificë. E prisnim të ndodhte. Është vetëm ana teknike



për t'u mbyllur, por të themi se kemi rënë dakord shumë kohë më përpara. Napoli e ka ndjekur që nga fillimi i sezonit lojtarin", ka thënë Alijaj. Për shtypin napolitan përzgjedhësi i Kosovës, Bernard Challandes, ka thënë se Napoli ka bërë një blerje të shkëlqyeshme. "Rrahmani është kapiteni i kombëtares sonë, si dhe mbrojtës i kompletuar dhe modern. Përdorë të dyja këmbët dhe është i shkathët me kokë. Ka një vetëbesim të veçantë me topin dhe i pëlqen të avancojë me top në pronësi. U përshatet shumë mirë nevojave të trajnerëve. Në Dinamo Zagreb luante si mbrojtës i majtë, por mund të luajë çdo kund në mbrojtje. Për shembull, në kombëtaren tonë luan në qendër me mbrojtje të rreshtuar me 4. Napoli ka bërë një blerje të shkëlqyer. Amiri ka një personalitet solid dhe është i qetë. Për pak kohë nën udhëheqjen time

është shndërruar në lider të mbrojtjes dhe zhveshtores. Nuk krijon probleme brenda zhveshtores", ka thënë Challandes. "Zgjedhje e përkryer për ta afruar kjo e Napoli. Akoma nuk kam komunikuar me të që nga Kërshëndellat, por që atëherë më pati treguar për këtë mundësi dhe i pata thënë që me një kalim të tillë do të bënte një hap të madh dhe kualitativ në karrierë. E këshillova vetëm që ta përmbylte sezonin me Hellas Verona dhe ta fillonte sezonin e ri me Napolin", ka deklaruar Challandes. Duhet cekur se 25-vjeçari ka luajtur për të rinjtë e Shqipërisë, më pas edhe për Kombëtaren A në dy ndeshje. Me pranimin e Kosovës në UEFA dhe FIFA, Rrahmani vendosi ta braktisë kombëtaren kuqezi dhe t'u bashkohet "dardanëve", ku aktualisht është kapiteni i Përfaqësueses me të cilën është paraqitur në 29 ndeshje dhe ka realizuar 5 gola.

SHKURT

Gjilani vazhdon përgatitjet në Turqi

Skuadra e Gjilanit të enjten ka "zbarkuar" në shtetin turk, vend ku do t'i vijojë përgatitjet për pjesën e dytë kampionale. Trajneri Gentian Mezani të premten ka filluar zbatimin e planit përgatitor për pjesën pranverore në këtë edicion. Gjatë qëndrimit në Turqi skuadra e Gjilanit do t'i luajë disa ndeshje kontrolluese, ndërsa e para do të jetë ajo kundër skuadrës Neftchi Kochkor e cila militon në elitën e futbollit të Kirgistanit, ndeshje e cila do të zhvillohet të dielën më 19 janar.

Përforcohet KB Bashkimi

KB Bashkimi nga Prizreni është përforcuar me alo qendrën amerikane, Spenser Mitchell. Basketbollisti i gjatë 203 centimetra ishte pjesë e skuadrës Lituanëze, Palangos, për të cilën ka luajtur me mesatare prej 6.4 pikëve dhe 5 kërcimeve për ndeshje. Më parë ka luajtur edhe në skuadrat si Swords Thunder nga Irlanda, Servigroup Benidorm nga Spanja dhe Perez Basket SAD nga Kosta Rika.

Flamurtari prezanton gjashtë futbollistë

Skuadra e Flamurtarit ka prezantuar të premten gjashtë përforcime për sezonin pranveror. "Mirë se vini në KF Flamurtar! Valdo Zeqaj, Altin Lloga, Arbër Mustafa, Bajram Shala, Donart Hasanaj, Lubomir Gucev", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi nga kryeqyteti.

Përfundon aventura e Avdijajt në Trabzonspor

Aventura në Turqi për futbollistin Donis Avdijaj ka zgjatur shumë shkurt. Ylli i Kosovës nuk ka pasur aventurë të mirë as te Trabzonspori. "beIN Sports TR" njofton se Trabzonspori dhe Avdijaj kanë shkëputur kontratën. 23-vjeçari ka regjistruar tetë paraqitje me Trabzonsporen në Superligën e Turqisë, gjatë edicionit 2019/20, duke shënuar një gol dhe një asistim. Ai ka pasur edhe dy paraqitje në Kupën e Turqisë, ku nuk ka arritur të lë gjurmë. Mbetet të shihet se cili do të jetë hapi i ardhshëm i Avdijajt.

Llapi angazhon trajnerin kondicional nga Turqia

KF Llapi ka arritur të angazhojë në kuadër të stafit teknik, trajnerin kondicional nga Turqia, Mustafa Serdar Basaran, i cili ka qenë pjesë e shumë klubeve të mëdha në Turqi. "Trajneri kondicional është angazhuar menjëherë me klubin në Durrës dhe qëllimi i tij është që futbollistët e Llapit të jenë fizikisht të përgatitur për stinorin e ri pranveror. Ai do të jetë pjesë e jona për periudhën kohore të 6 muajve në vijim", thuhet në njoftimin e Llapit. 41-vjeçari ka punuar në këto klube: NK Çelik, Instambulspor, Adanaspor, Adanademirspor FK, Denizlispor FK dhe në Kombëtaren e Turqisë gjatë fazës përgatitore.

Vitija nënshkruan kontratë profesionale me Prishtinën

Mbrojtësi i majtë, Ermal Vitija, në praninë e drejtorit sportiv, Granit Begolli, ka nënshkruar kontratë profesionale me skuadrën e Prishtinës. 19-vjeçari është produkt i Shkollës së Futbollit "Prishtina" dhe ka luajtur nëpër të gjitha grupmoshat e këtij klubi. Ermali me ekipin e parë ka zhvilluar dy ndeshje zyrtare, një kampionale me Llapin në Podujevë dhe kundër Minatorit për Kupë. "Pas performancës së treguar në seancat stërvitore, shtabi teknik i prirë nga Armend Dallku ka vendosur që futbollisti në fjalë e meriton të promovohet në mesin e futbollistëve me kontrata profesionale", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Ronaldinho: Ndryshuam historinë me Barçën, Messi nuk krijonte probleme

BARCELONË, 17 JANAR - Braziliانى Ronaldinho ishte një prej futbollistëve më të dashur deri kur vari këpucët në gozhde, por edhe problemet e tij financiare e ato me drejtësinë (së fundmi) nuk e kanë zbehur afeksinonin e tifozëve. "Ishim një grup loj-

tarësh që po përjetonim formë të mirë te Barcelona dhe arritëm ta ndryshonim historinë. Që në ditën e parë ishin mijëra tifozë që më prisnin në stadium dhe Rajkard ishte trajneri më i mirë me të cilin kam punuar. Dinte se si funksiononte loja, pasi kishte

qenë vetë në nivelet më të larta. Më dha liri në fushë pavarësisht kërkesave taktike. Ishte bukur të shikoja dhe rritjen e Lionel Messit, pasi mësuam shumë bashkë. Ai është një njeri i qetë dhe asnjëherë nuk futet në probleme", ka thënë Ronaldinho, i

cili ka lavdërua edhe Milanin. "Kishim një ekip të mrekullueshëm. Në fushë Kaka, Pirlo, Beckham, Seedorf, Ibrahimoviç, Thiago Silva, Gattuso, Maldini. Edhe mua më dukej si një seleksion i më të mirëve të botës në atë kohë", ka shtuar Ronaldinho.



Rivalet e vjetër ndajnë mejdantin në 'Karagaçi'

PRISHTINË, 17 JANAR - Xhiroja e 21-të e Superligës së Kosovës në basketboll do ta sjellë superderbin ndërmjet rivalëve të vjetër, Pejës dhe Sigal Prishtinës. Klasikja e basketbollit pritet të jetë shumë interesante, me Pejë që ka bërë disa përforsime dhe ka synime të mëdha për stinorin pranveror. Përforsimi më i madh pa dyshim është Dardan Berisha, i cili kaloi pikërisht nga Prishtina. "Bardhekaltrit" janë kampionë dhe liderë të tabelës dhe synojnë të vazhdojnë të mbesin në vendin e parë. Prishtina ka 14



fitore dhe katër humbje, kurse Peja nëntë fitore dhe tetë humbje. Ndashja e parë e kësaj xhiroje do të zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Lipjanit. "Vreshtarët" ndodhen në vendin e dytë me 13 fitore dhe pesë humbje, kurse lipjanasit kanë një fitore dhe 17 humbje. Takim interesant do të zhvillohet edhe ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Trepçës. Skuadra therandase ka

12 fitore dhe gjashtë humbje, duke u renditur në vendin e tretë me 30 pikë, kurse mitrovicasit kanë katër fitore dhe 13 humbje dhe momentalisht janë në pozitën e tetë. Ndashja e fundit për këtë xhiro do të zhvillohet në mes të Ponte Prizrenit dhe Feronikelit. Prizrenasit kanë dhjetë fitore dhe tetë humbje, kurse skuadra nga Drenasi ka pesë fitore dhe 13 humbje.

SUPERLIGA - Java 21

Të shtunën takohen:
17:00 Rahoveci - Lipjani
19:00 Golden Eagle Ylli - Trepça

Të dielën takohen:
17:00 Peja - Sigal Prishtina
19:00 Ponte Prizreni - Feronikeli
Bashkimi (pushon)

Golden State regjistron humbjen e dhjetë radhazi

SAN FRANCISCO, 17 JANAR - Skuadra që ka bërë ligjin në pesë vjetët e fundit në NBA, Golden State Warriors, duke fituar tre tituj kampionë, pësoi disfatën e 34-të sezonale në 43 takime dhe të 10-n rresht me Golden State që po djeg që në gjysmën e sezonit të rregullt çdo mundësi për ta kapur fazën "play-off". Këtë herë Golden State u mposht në "Chase Arena" në San Francisco nga Denver Nuggets me rezultatin e ngushtë 131-134 pas kohës shtesë. Bartonit me 31 pikë dhe Beasley me 27 ishin dy lojtarët më të mirë mbi parket për skuadrën nga Colorado të cilët bënë dallimin në këtë sfidë. Nuk pati të njëjtin fat si ndaj Los Angeles Lakersit edhe ndaj Los Angeles Clippersit, skuadra e Orlando Magicut, që këtë herë u mposht në "Staples Center" nga



skuadra tjetër kaliforniane me rezultatin e thellë 122-95. Kawhi Leonard ishte ai që udhëhoqi Clippersin drejt fitores së 29 sezonale me 32 pikë, 5 rebounde dhe 5 asistime. Vijnë forma e Milwaukee Bucksit që siguroi fitoren e 31-të në 34 ndeshjet e fundit teksa kaloi me shifrat e ngushta 128-123 Boston Celticsin. 40 pikë, 11 rebounde dhe 3 asistime nga Kemba Walker ishin të pamjaftueshme për Celticsin, ndërkohë që dallimin e bëri i përhershmi Giannis Antetokounmpo, i cili

realizoi 32 pikë, ndërsa shtoi edhe 17 rebounde e 7 asistime në suksesin e Bucksit, raporton "SS". Një ndeshje spektakolare ishte edhe ajo që u zhvillua në "Smoothie King Center" në New Orleans, aty ku Pelicansi mposhti, pas kohës shtesë, Utah Jazzin me shifrat 138-132. Thjesht, magjik në këtë sfidë 22-vjeçari, Brandon Ingram, i cili koleksionoi 49 pikë për Pelicansin, ndërkohë që për Utah spikati i përhershmi Mitchell me 46 pikë.

REZULTATET

New York - Phoenix 98-121
Milwaukee - Boston 128-123
New Orleans - Utah Jazz 138-132
Golden State - Denver 131-134
Clippers - Orlando 122-95

SHKURT

Bryant: Në Itali kam qenë dëshmitar i racizmit

Pa dyshim se nuk është një kujtesë e mirë ajo e Kobe Bryantit, një legjendë e NBA-s, nga fqinji ynë përtej Adriatikut. I intervistuar nga CNN, ish-basketbollisti i njohur theksoi se racizmi është një problem i vjetër në Itali. Bryant, i cili u rrit në Itali, ndërsa babai i tij luante me Rieti, Reggio Calabria, Pistoia dhe Reggio Emilia, ka thënë se kishte qenë dëshmitar i episodeve të racizmit: "Kur isha duke u rritur, unë pashë dëshmi të tilla, gjëra të dorës së parë, gjatë disa ndeshjeve në futboll. Prindërit e mi më mësuam se si t'i trajtoja këto gjëra". Për fat të mirë, situata është duke u përmirësuar gradualisht sot por, sipas Bryant, ka ende shumë për të bërë: "Unë mendoj se të flasim për racizmin në sport dhe të marrim një pozicion është e rëndësishme. Ne kemi përshkuar një rrugë të gjatë, por ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Gjëja më e rëndësishme është arsimimi".

Ndryshon formati i Ligës së Kampionëve



Mesa duket Liga e Kampionëve do të ndryshojë format. Të pak-tën, sipas prestigjiozës "Times", që flet për këmbënguljen e klubeve të mëdha evropiane për ta ndryshuar veprimtarinë kryesore në kontinent brenda vitit 2024. Ideja është që veprimtaria të ketë katër ndeshje më shumë sesa aktualisht dhe idetë janë dy: të rikthehen grupet e dyfishta ose të ndryshohen grupet duke i kthyer me gjashtë skuadra secilin. Mesa duket ka një pajtim me ECA-s dhe UEFA-s për këtë çështje. Aktualisht, dy skuadrat që mbërrijnë në fund të turneut dhe diskutojnë finalen e madhe, zhvillojnë secila nga 13 ndeshje, ndërsa me formulën e re do të luanin nga 17 ndeshje secila.

Cisse: Mane mund të bëhet më i miri në botë

Ish-sulmuesi i Newcastle dhe Senegalit, Papiss Cisse, ka thënë se sulmuesi i Liverpoolit, Sadio Mane, është i aftë të bëhet lojtari më i mirë në botë. Paraqitjet e Manes në sezonin 2018-2019 e panë atë të bëhej i pakapshëm nën urdhrat e Jurgen Klopp, duke fituar "Këpucën e Artë" në Ligën Premierë, të siguruar përkrah një triumfi në Ligën e Kampionëve. Mane pastaj përfundoi i katërti në votimin për "Topin e Artë", por fituesi Lionel Messi deklaroi se ai duhet të kishte qenë një pretendent serioz për çmimin. "Mane po bën shumë mirë te Liverpooli dhe e dija që ai do ta ngjitej në krye, por ai mund të bëjë edhe më shumë. Nëse po bëni diçka të tillë dhe i arrini këto nivele, atëherë nuk mund të ndaleni, duhet të shtyni përsëri për të treguar që mund të bëni edhe më shumë. Sa herë që flasim në telefon i them: 'Mund ta bësh atë, mund të bëhesh më i miri. Besoni në veten tuaj'", ka thënë Cisse për "The Sun".

Mercedesi prezanton makinën e re më 14 shkurt

Mercedesi ka njoftuar se më 14 shkurt do ta hedhë në treg makinën e re në kampionatin Formula 1 2020. Kampioni botëror Mercedes njofton se më 14 shkurt do ta hedhë në treg makinën e re në kampionatin Formula 1 2020, për Lewis Hamilton dhe Valtteri Bottas. Vetura W11 do t'i kryejë kontrollin e para atë ditë. Mercedesi ka fituar gjashtë titujt e fundit të konstruktorëve dhe vitin e kaluar Hamiltoni mori një titull të gjashtë botëror përpara Bottas. Ai tani do të synojë ta kapë rekordin e shtatë titujve të Michael Schumacherit. Rivali Ferrari është skuadra e parë që zbuloi makinën e tij të re, më 11 shkurt.

	1	Autor: GAZMEND MORINA	SABOTAZHET	PËRHAPJE E VALEVE	MUZIKANTI KISERI (shq.)	TË FIKËT	NORA ISTREFI	ZANORE	EPOKA ERE	HEROI NË FOTO 2	SHKENCA QË STUDIOJ MORALIN	MINDERI I ULËT (krah.)	PËREMËR PRONOR	KRIPË E ACIDIT NITRIK		
	LUMË NË SHQIPËRI								TENISTJA BELGE JUSTINE GLOBAL ARBITRATION REVIEW							
	BAR PËR TË DALË JASHTË (shq.)							GATESA BASHKËT.								
	AKTORI HOLLIVUDIAN ... STILLER (shq.)							NDESHJET ANA RUSO								
	KRYEQYTETI I KANADASË								KËNGËTARI PORTORIKAN ... MARTIN ISMET JASHARI					ROSTOCK NJË LLOJ BUFI		
	VOZË E MADHE DRURI QË SHËRMBEN PËR TË MBAJTUR DJATHË (shq.)									NOTË MUZIKORE ZANORE				KAPËRDIJ KOD I TELEFONIT MOBIL		
INTENSITET, METËR; INDIUM								VIJË QË SHPIE UJIN NË MULLI	A				IDHULL RAMADAN (perkdh.)			
EPOKA ERE	HEROI NË FOTO 1	ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER	GJUMI I THELLË (med.) ARKA PREJ HEKURI KU RUHEN PARA		BASHKËT. NIKEL, AZOT										PUSULLAT	
TRADITË, ADET (sh.pashq.)																
BANOR I VIETNAMIT TË VJETËR															ZANORE KËNGËTARI AMERIKAN ... BROWN (shqip.)	
PATRIOTI YNË PRISHTINA								NË ÇFARË MASE							KASTRIOT TUSHA VEPRIMTARI I SHQUAR BEQIRI	
GRIMCOVA (bised.)				UGANDA, TANZANIA	SIENA MALLKOJ										JO I VJETËR JETËSHKRIM	
AKTORI YNË NASER																
I MBUSHUR TËRËSISHT; I								KUVENDI I KOSOVËS							BASHKËT. MARC ANTHONY	
AJËR (ang.)				MITRUSH KUTELI PARIM I QARTË E I PËRCAKTUAR MIRË			AMERICAN PUBLIC MEDIA	TEDI ALVES	SHKENCA QË STUDIOJ MORALIN	TREVISO	BOTIMI				DIJETAR FETAR MYSLIMAN TANI	
BASHKËT.		TINKA KURTI NJË STINË			BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI PËREMËR PRONOR										SHTET (hua)	
DËMTIM I NJË MEKANIZMI GJATË LËVIZJES								PËRFUNDIM NË SHAH FILM I YNI "... ISHIN KATËR"							DRIËRO AGOLLI FUTBOLLISTI DANIELE (MILAN)	
ZAMBIA, ESTONIA			I PARI I XHAMISË (pashq.) ISH FUTBOLLISTI SHAQIRI						EMËR MASHKULLI MYSLIMAN BASHKËT.							
PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (vjet.)								FUTBOLLISTI ANGLEZ ... PARKER (TOTENHAM) GJYMTYRË E TRUPIT							NGASËSI I "Formula 1" ... HAKINEN	
ISH FUTBOLLISTI IGLI					ALFRED KACINARI PJESETAR I AONËVE			MBAJTJE E ANËS TRAJNERI GJERMAN REHAGEL								
INTER		DIREK I ÇATISË SHKRONJA TË NJËJTA					"RODA" RIADI, DAKARI		ISH SOLISTJ ANGLEZE WINEHOUSE (shqip.) OSMAN XHAKA							
EPOKA ERE	KAM NJOHURI PËR DIÇKA ZANORE				QË KA TË BËJË ME ORATORINË OSAKA											
HEROI NË FOTO 3															ZANORE	
																

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "PROMO KOS", SH.P.K. me seli në Prishtinë, lagja Kalabria, zona A1 H C/1 nr. 2, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810199275 dhe ka caktuar likuidatorin Shaban Ismajli nr. Kontaktues +38344194334 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "PROMO KOS" D.O.O. od Pristina, lagja Kalabria, zona A1 H C/1 nr. 2, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810199275 ujedno imenovao Likvidatora Shaban Ismajli nr. +38344194334o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "PROMO KOS" L.L.C. in Prishtina, lagja Kalabria, zona A1 H C/1 nr. 2 has come to the decision to quit its business: 810199275 the company has appointet a liquidator Shaban Ismajli nr. +38344194334wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "EU JOBS", SH.P.K. me seli në Prishtinë, Kalabri, Aldex Lok 1, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810874695 dhe ka caktuar likuidatorin Shaban Ismajli nr. Kontaktues +38344194334 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "EU JOBS" D.O.O. od Pristina, lagja Kalabri, Aldex Lok 1, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810874695 ujedno imenovao Likvidatora Shaban Ismajli nr. +38344194334o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "EU JOBS" L.L.C. in Prishtina, Kalabri, Aldex Lok 1, has come to the decision to quit its business: 810874695the company has appointet a liquidator Shaban Ismajli nr. +38344194334 wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "KOS-GER.DE", SH.P.K. me seli në Prishtinë, lagja Kalabria, B-II-C6-1, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810174136 dhe ka caktuar likuidatorin Shaban Ismajli nr. +38344194334 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "KOS-GER.DE" D.O.O. od Pristina, lagja Kalabria, B-II-C6-1, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810174136 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije, Shaban Ismajli nr. +38344194334 Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "KOS-GER.DE" L.L.C. in Prishtina, lagja Kalabria, B-II-C6-1, has come to the decision to quit its business: 810174136 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator proces Shaban Ismajli nr. +38344194334. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës Nr.03L/212 dhe nevoja të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës së përcaktuar në Organogramin e ri të Ndërmarrjes për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 18.01.2020 të shpallë :

KONKURS I BRENDSHËM

Për plotësimin e vendit të punës ;

- Udhëheqës i Administratës
- Me kohëzgjatje një vjeqare, me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë ;

- Organizon, koordinon dhe udhëheq me punët e zyrtarëve të administratës
- Merrë pjesë në krijimin e politikës afariste nga lëmia e administratës
- Jep ndihmë në punë komisioneve dhe organeve tjera në Kompani
- Kujdeset për standardin shoqërorë të punëtorëve
- Bënë përpilimin e projekteve të akteve normative në nivel të Kompanisë
- Bënë interpretimin dhe sqarimin e dispozitave të akteve normative dhe ligjeve tjera në fuqi lidhur me realizimin e administrimit
- Kryen edhe punët dhe detyrat tjera të punës të cilat i ipen nga punëdhënësi (Drejtori menaxhues)

Kualifikimet e kërkuara :

- Shkollimi universitar
- Dëshmi që nuk është nën hetime
- Letërmotivimi
- Kopja e lëternjoftimit

Aplikacionet së bashku me diplomën, referencat dhe dokumentet tjera mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 18.01.2020 deri më 02.02.2020.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacionin përkatës, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Data: 18.01.2020

Kryeshefi Ekzekutiv në bazë të nenit 17 paragrafi 3, pika 1 e Statutit të HK-Trainkos-SH.A. nr. 1/188, të datës 05.10.2015, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe në bazë të nenit 4 të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MPMS) NR. 07/2017, shpall:

K O N K U R S

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Teknologji Informative IT

Institucioni: Hekurudhat e Kosovës-Trainkos-SH.A.

Tipi i Akt Emërimit të punës: Orar të plotë pune

Titulli i mbikëqyrësit: Menaxherit të Sektorit të Logjistikës dhe IT

Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi

Koeficienti/Kategoria: K – II/22

Procedura e aplikimit: I jashtëm

Vende të lira punë: 1 pozitë (vend pune)

Vendi: Fushë Kosovë

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe funksionimin e serverëve të kompanisë dhe të teknologjisë informative,
- Kujdeset dhe përcjell në vazhdimësi funksionimin e rrjetit të internetit dhe të intranetit.
- Përmes Zyrtarit të TI është përgjegjës për instalimin, konfigurimin, mirëmbajtjen e rrjetit dhe pajisjeve të TI (PC, Printer, Fotokopje, etj),
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit të infrastrukturës si AD, DNS, DHCP, Exchange Server, ISA Server dhe sistemeve të reja që do të futen,
- Mirëmban server dhe është përgjegjës edhe për zhvillim të Softuerit në kompani.
- Mirëmban Ueb Sajtin, bën zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të reja që mund të zhvillohen brenda TI-së për nevojat e Kompanisë,
- Konsultohet me Kompanitë e jashtme për sistemet që zhvillohen jashtë Kompanisë.

Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Të këtë të kryer shkollim Universitar, Fakulteti Teknologjise Informative,
- Te këtë përvojë pune ne këtë pozitë,
- Preferohet njohja e gjuhës angleze,
- Të këtë të bashkangjitur edhe CV-në personale,
- Të jetë i sjellshëm dhe komunikativ,
- Të jetë i aftë të punoj nën presion,
- Vertetimin që nuk është nën Hetime,

Titulli i pozitës së punës: Sigurim Fizik i Objekteve

Institucioni: Hekurudhat e Kosovës-Trainkos-SH.A.

Tipi i Akt Emërimit të punës: Orar të plotë pune

Titulli i mbikëqyrësit: Shefit të Njesisë së Sigurimit Fizik

Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi

Koeficienti/Kategoria: K – V/123

Procedura e aplikimit: I jashtëm

Vende të lira punë: 10 pozita (vend pune)

Vendi: Fushë Kosovë

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Bën ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe të pasurisë së Trainkos Sh.A,
- Përkujdeset për sigurinë e brendshme në të gjitha hapësirat dhe objektet e Trainkos Sh.A.,
- Tërheqin vërejtjen personave të cilët pa autorizim përkatës ofrohen në hapësirën e siguruar, ndërtesën ose vendin të cilën e siguron,
- Kërkon që personat që e rrezikojnë sigurinë e njerëzve dhe/ose të pronës brenda hapësirës së siguruar, të ndërpresin menjëherë veprimet e tyre,
- Identifikon personat dhe automjetet gjatë hyrjes dhe daljes nga rajoni i siguruar nëse është e domosdoshme për njerëzit dhe/ose pronën,
- Bën ndalimin e personave që zihen duke kryer vjedhje apo dëmtime të pasurisë së Trainkos Sh.A,
- Është i obliguar që menjëherë të lajmëroi Shefin e Njesisë si dhe Policinë e Kosovës, në rast se evidenton vjedhje apo dëmtim të pronës së Trainkos Sh.A.,
- Marrjen e masave për ruajtjen e gjurmëve të veprës penale si dhe ruajtjen e mjeteve me të cilat është kryer vepra penale,
- Ruan të gjitha shënimet për rastet e cekura më lartë (vendi i kryerjes, data, shënimet të cilat qojnë në identifikimin e kryesit të veprës penale, si dhe shënimet mbi lajmërimin e personave zyrtar të PK-së duke përfshirë: datën, orën, njësinë dhe emrin e zyrtarit të PK-së,
- Mbanë evidencën në ditarin e punës mbi gjendjen e siguris për çdo 1 (nje) ore.
- Njofton Shefin e Njesis për çdo parregullsi në vrehet ne Objekte dhe Asete,
- Kryen detyra tjera të caktuara nga Shefi I Njesisë;
- Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi i përgjigjet Shefit te Njesisë,

Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Të këtë të kryer shkollën e mesme,
- Të dëshmoj Çertifikatën Mjekësore për punë,
- Të jetë i sjellshëm dhe komunikativ,
- Të jetë i aftë të punoj nën presion,
- Preferohet të këtë përvojë pune në këtë lëmi,
- Vërtetimin që nuk është nën hetime,

Aplikacioni dhe konkursi mund të merret në ndërtesën e Drejtorisë në Fushë Kosovë apo në www.trainkos.com. Aplikacioni së bashku me dëshmitë të dorëzohen në ndërtesën e Drejtorisë së HK-Trainkos-SH.A. në adresën "Sheshi i Lirisë" nr. 22, në Fushë Kosovë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur, në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 03/02/2020 ora 16:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk iu kthehen. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Sot bëhen 24 vjet nga ndarja jonë

Avdi Kelmendi

(21.12.1951-18.01.1996)

Janë bërë shumë vite tashmë që kur u pamë për herë të fundit. Ti qëndroje i buzëqeshur e hijerëndë në vendin e preferuar, me ballin e rënduar ca nga rrudhat e vuajtjeve e burrnisë, por me sytë e kaltër që kishin akoma pakëz nga çiltërsia fëmijërore. Atëbotë nuk është se thamë fjalë të mëdha, e as porosi, sepse të gjitha ato ti i kishe folur tashmë. Porosinë për njerzllëkun, dinjitetin, dashurinë ndaj Atdheut...

Megjithatë, tash kur shumë nga ne jemi gati moshatarë me ty, nevoja e madhe për qetësinë e shpirtin luftarak të babës ndjehet secilën herë më shume. Mوندohemi ta jetojmë jetën drejt e dinjitetshëm siç e jetoje ti, mbase ky është dimensionin ku ne takohemi e i shtrëngojmë duart çdo ditë me ty, si dikur.

Mall është fjalë e varfër për ta përshkruar atë që ndiejmë për ty.

E kujtojmë me mall vëllezërit: Isufi dhe Ganiu motrat: Aferdita, Shpresa bashkshortja Sabria djemt: Petriti, Gjirokastriti, vajzat: Nora Dadanesha dhe Teuta, rejat: Nuria, Yllka; nipat: Etniku, Kaoni, Arvaniti si dhe mbesa Epika.

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Vullnet Mucaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Naim Meta shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni " Prizren
- ▶ Adnan Qehaja shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Sejdi Bicaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Motrat Qirazi" Prizren
- ▶ Artan Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur
- ▶ Xheladin Nuredini shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Drita Cejku shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Egzon Shala shpell te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtime i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.

Tel. 044-413-197.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues